



"FUNDJAVA" ▶ Faqe 13-20

**Grëfimi i Kristaq Skramit: Unë drejtori me rolin e Dukës në Londër**



**Vrasja në Tiranë**  
Palestinezi Rizik mori kërcënime me vdekje

▶ Faqe 6



**Olen Cezari**  
Rruga e pagabueshme e gjenit te violinës

▶ Faqe 22-23

# [SHQIPTARJA.com]



LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi FUNDJAVA

VITI II - NR. 110 E premte, 11-05-2012

Zbardhen emrat e deputetëve që morën çertifikata te universiteti ku u diplomua Bossi

## DEPUTETET, DIPLOMA TE KRISTAL Bëhen "doktorë" pas hyrjes në Kuvend

Deputetët me dy-tre diploma dhe grada të larta shkencore. Nga Doktoratura sekrete e kryetares Jozefina Topalli te titujt akademikë të ligjvënësve shqiptarë, marrë vitet e fundit

FOTOT ▶ Faqe 8



**Bar-Kafe te Kuvendi, pa kasë tatimore dhe me letra bakalli**

RAPORTI ▶ Faqe 10

**UNICEF: 100 mijë familje në varfëri ekstreme**

EKSPERTET ▶ Faqe 11



**Shitja e HEC-it Lanabregas paratë i mori qeveria**

REFUZIMI ▶ Faqe 10

**Parada gay, asnjë deputet nuk konfirmon pjesëmarrjen**

### Lajmi

Shumica e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, janë pajisur vitet e fundit me gradën shkencore "Doktor", apo tituj të tjerë shkencorë, ndërsa disa prej tyre kanë marrë edhe diplomë për Juridik te universiteti "Kristal". Siç mund të shihet edhe nga CV-të e tyre shumica janë graduar si juristë.

Në foto: Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe sarkazma e deputetit Harasani me diplomën e "Kristal"



**TIRANE**  
ARBEN RROZHANI

Dy vite më parë, kryetarja e Kuvendit, mori gradën shkencore "Doktor". Zonja Topalli kishte mbrojtur doktoraturën për të drejtën Kushtetuese në fakultetin Juridik të Tiranës, me...

▶ vijon në faqe 6-7

### Editorial



NGA ANILA BASHA

## Rama & Nano vs Berisha & Blushi?

Interesante ishte tabloja politike e ditës së djeshme. Politika nuk u lë kohë qytetarëve të mendojnë për hallet e problemet që ka gjithsecili, por duhet të mendojnë në tryezat e tyre për problemet që ka vetë politika. Dhe ja ku ndodhi mbërmbjen e djeshme kur u pa qartë se dalja televizive e Ben Blushit, anëtar i kryesisë së PS, deputet i kësaj partie, në Ufo TV, përballë një paneli gazetarësh, ishte qartazi një tentativë për të "eklipsur" sado pak, daljen publike të Edi Ramës, pas gati 5 vitesh në televizionin Klan, pikërisht në atë televizion që ai e ka përkufizuar gjithmonë e më shumë kohët e fundit, vetëm me shprehjen "T'fala Sandrit" duke mos begenisur asnjëherë t'i kthejë përgjigje serioze. Se çfarë do të thoshte Edi Rama seriozisht, në TV-në që nuk e kishte konsideruar asnjëherë seriozisht, kjo u pa ditën e djeshme, kur nuk ngurroi të deklarojë se e ka takuar Ilir Metën, se shprehjet që kishte deklaruar më parë për të, që pas zgjedhjeve të 2009, ishin pjesë e historisë, e mandej duke rrëfyer se çfarë planesh kishte PS dhe forca që ai udhëheq në çështje të rëndësishme politike, nga presidenti deri te zgjedhjet. E aq më tepër duke reaguar aq gjaktohetë përballë gjithë inserteve "provokative" të përgatitura mjeshhtërisht nga "kurthi" gazetaresk.

Sipas gjithë sondazheve online ditën e djeshme, u pa qartë se tentativa "Blushi" për të marrë audiencë ishte një përpjekje disi dëshpëruese, edhe pse prej të gjithëve mendohej se Rama nuk do të thoshte...

▶ vijon në faqe 5

### INTERVISTA E KREUT SOCIALIST

## Edi Rama: Presidenti as nga PS duhet nje figurë konsensusi

Kryesocialisti: Një emër mbi palët. Flet edhe Blushi. Berisha refuzon Nanon

**TIRANE**

JAKIN MARENA

**NERANXI**  
1997

... gjithmonë një hap përpara...

**Patatina Nachos dhe Meksikane shoqëruar me salcat dhe djathin përkatës**

Adresa: Autostrada Tiranë- Durrës, km 7, Yrëhek Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

Kryetari socialist Rama është shprehur se iniciativën e tij të takimeve me liderët kryesorë të politikës e ka ndërmarrë për të garantuar një proces të...

▶ Faqe 2-3-4-5





## Topalli-Tsacheva: E ardhmja e Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Bullgaria beson në të ardhmen Evropiane të Shqipërisë dhe ajo do ta mbështesë vendin tuaj në aspiratën për marrjen e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian", Kështu u shpreh kryetarja e Kuvendit Popullor të Bullgarisë, Tsetska Tsacheva, gjatë konferencës për shtyp me kryeparlamentaren, Jozefina Topalli. Kryetarja Topalli e vlerësoi vizitën e homologes bullgare "një vlerë të shtuar"


që i shërben thellimit të bashkëpunimit dypalësh. Ajo theksoi se marrëdhëniet mes dy vendeve bazohen në një traditë të gjatë historike, kulturore, ekonomike dhe tregëtare, por sipas saj këto duhet të materializohen edhe më tej. Topalli vlerësoi angazhimin e homologes bullgare për të mbështetur Shqipërinë në procesin e marrjes së statusit në BE. Ajo gjithashtu shprehu kënaqësinë se sot numri i grave si

kryetare të parlamentit është rritur shumë dhe kjo sipas saj është shprehje e civilizimit dhe progresit. Nga ana e saj, kryetarja e parlamentit bullgar e vuri theksin tek nxitja e projekteve të përbashkëta në fushën ekonomike, në energjetikë, turizëm, sporte. Gjatë vizitës në Tiranë, kryeparlamentarja bullgare do takohet me kryeministrin Berisha, presidentin Topi dhe ministrin e Integritimit, Bregu.

Kryeministri pret Nanon, vlerëson figurën e tij. Ish-kryesocialisti hesht për mediat

# Berisha "kthen" duarbosh Nanon: Presidenti nga PD

"Mazhoranca e zgjedh vetë Presidentin. Me aleatët pas SHBA"



### Lajmi

Kryeministri Berisha dhe ish-kryetari socialist Nano, njëherësh dhe kandidati i vetëshpallur për postin e Presidentit, janë takuar në zyrën kryeministore. Nano ka shpalosur platformën për zgjedhjen në krye të shtetit, ndërsa Berisha duke vlerësuar figurën e tij tha se, do të mbështesë një personalitet të PD.



### Ambasadori

Arvizu: 84 vota për Presidentin



Kreu i ambasadës amerikane në Tiranë ka thënë që kreu i shtetit duhet të zgjidhet me 84 vota dhe në raundin e parë. "Të jem i sigurtë objektivi duhet të jetë që presidenti të zgjidhet që në raundin e parë, pra me 84 vota, duhet të shmangen raundi i katërt apo i pestë", tha Arvizu pas takimit me kreun e PS, Rama. "Jam i kënaqur që nuk do të jetë një mendim i vetëm. Janë përfshirë të gjithë palët politike. Shpresoj të krijohet një bazë e përbashkët për të arritur tek zgjedhja e presidentit", tha Arvizu. Sipas tij, kreu i shtetit duhet të përfaqësojë unitetin e popullit dhe për këtë proces parti të duhet të dialogojnë gjatë, duke përmendur kryeministrin Berisha, kreun e PS Rama dhe liderin e LSI, Meta.

mënyrë konsuale të Presidentit të Republikës në vitin 2002, pikërisht të një kandidati të propozuar nga PD që ishte Presidenti Alfred Moisiu, por dhe emerimi i Prokurorit të Përgjithshëm dhe numrit dy të SHISH si përfaqësues të opozitës së atëhershme. Sipas zyrës së shtypit, Berisha e garantoj zotin Nano se ai personalisht dhe si kryeministër vlerëson të gjitha marrëveshjet e arritura së bashku në të shkuarën në interesin më të mirë të vendit, kontributin e këtyre marrëveshjeve në zgjidhjen e sfidave e problematikave. "Nga ana tjetër Kryeministri theksoi se, qëndrimi i bërë tashe publik në mënyrë të përsëritur prej tij ndaj kandidatit të zotit Nano për President të Republikës, ka lidhje tërësisht me spektrin politik, detyrimet që rrjedhin nga përkatësitë e ndryshme në këtë spektër dhe se ai mbështet dhe do të mbështesë një personalitet të shquar të Partisë Demokratike në postin e Presidentit të Republikës", thuhet në njoftim, ku specifikohet se qëndrimi ndaj kandidatit të Nano ka të bëjë thjeshtë për faktin se ai është përfaqësues i një kampi tjetër politik dhe se mund të mbështesë vetëm një kandidat të dalë nga PD. Megjithatë kreu i qeverisë ka lënë për diskutuar gjithçka pas kthimit nga SHBA. "Kryeministri Berisha theksoi se pas kthimit nga Samiti i Chikagos ai do të hapë negociatat me aleatët e tij pa përjashtuar faktorët të tjerë, i bindur se mazhoranca aktuale i ka të gjitha mundësitë për të dhënë vendit Presidentin e ardhshëm", thotë njoftimi.

## Presidenti Deputetët e PD: Berisha, lojtari më i mirë në politikë, mazhoranca vendos

TIRANE

TIRANE JAKIN MARENA

Kryeministri Berisha s'ka lëvizur nga qëndrimi i tij i mëparshëm për një president të dalë nga radhët e personaliteteve më të rëndësishme të PD. Një qëndrim të tillë ia ka konfirmuar dhe ish-kreu socialist dhe aspiratit për postin e kreut të shtetit, Fatos Nano në takimin e zhvilluar ditën e djeshme në zyrën kryeministore. Duke mos dhënë asnjë mbështetje për ish-kreun e socialistëve dhe duke paralajmëruar se një enigmë e tillë do të zgjidhet menjëherë pas kthimit nga SHBA, pas takimeve dhe me aleatët brenda koalicionit të mazhorancës dhe faktorëve relevantë në PD, Berisha tha se mazhoranca aktuale i ka të gjitha mundësitë t'i japë vendit një President të ri. Takimi ka zgjatuar gati 40 minuta, ndërsa kreu socialist s'ka dhënë asnjë deklaratë për median, e pandodhur deri më tani nga ai. I cili është rikthyer në zyrën kryeministore që kishin pasur, plot 7 vite nga humbja e zgjedhjeve dhe dorëzimi tek Berisha i qeverisjes, këtë herë për të kërkuar nga pasardhësi i tij mbështetje për të marrë postin e kreut të shtetit. Berisha në takim ka

Duke i dhënë sfondin e një ndeshjeje sporti momentit politik të zgjedhjes së Presidentit, deputetët demokratë, Edi Paloka e Fatos Hoxha shprehën të sigurt se ai do zgjidhet nga PD. "Mazhoranca ende nuk ka hyrë në lojë për Presidentin pasi është mazhoranca ajo që do të vendosë se kush do të jetë presidenti", tha Paloka. Takimin e Ramës me Metën, demokratët e komentojnë si ndjesë të kryesocialistit për gjithë akuzat që ka ngritur ndaj tij. "Duket që Rama ka gjetur mënyrën për t'i kërkuar ndjesë zotit Meta për gjithë sulmet e paskrupullta që i ka bërë deri pak kohë më parë. Të mos harrojmë që u vranë 4 vetë më 21 janar pasi Rama i lëshoi si mish për top, pas asaj nxitje që bëri për sajesisë për zotin Meta. Uroj që Meta t'i ketë mbajtur shënim ato që ka propozuar zoti Rama, në bllokun famshëm për të cilin ka protestuar dhe bërë mitingje kundër kësaj qeverie", tha Paloka. Duke nënvizuar se "pavarësisht diskutimeve, konsultimeve pa votën e mazhorancës akush s'mund të bëhet presi-



dent". Në të njëjtën linjë ka qënë dhe deputeti Hoxha. "Po të shikosh me kujdes lëvizjet e tij, veçanërisht provën e forcës që bëri për të vjedhur anëtarin e KLD, të gjitha këto takime në këndvështrimin tim janë provë, janë insinuata që duan të përgatisin një vjedhje për Presidentin", tha Hoxha. Për të cilin "nese ka një titull në sport mjeshtër i madh, në politikë duhet një titull që t'i akordohej Berishës "Mjeshtër i madh i politikës". Deklaratë kjo e mbështetur dhe nga nënkryetari i grupit të PD, Paloka sipas të cilit, lideri i tyre është lojtari më i mirë në politikën shqiptare.

qënë me drejtorin e tij të kabinetit, Bylykbashi ndërsa Nano nën shoqëriën e Kullës. Pak kohë pas përfundimit të takimit zyra e shtypit e qeverisë konfirmon në mënyrë të përmbledhur qëllimin e cfarë u tha në këtë përballje të dy

njerëzve që kanë dominuar politikën shqiptare të këto vite. Sipas saj "në këtë takim, që u zhvillua në selinë e Këshillit të Ministrave, ish kryeministri Fatos Nano, i parashtrori kryeministrin Berisha kërkesën për të mbësht-

etur kandidatun e tij në postin e lartë të Presidentit të Republikës, duke shprehur bindjen se bashkëpunimi në kuadrin Kushtetues do ishte i dobishëm për vendin dhe objektivat e tij, si dhe duke evokuar disa nga marrëvesh-

jet e arritura në të shkuarën në zgjidhje të sfidave të vendit". Çka tregon se Nano s'ka munguar të kujtojë për Berishën marrëveshjet e arritura në kohën kur ai ishte në pushtet, marrëveshje që kanë të bëjnë me zgjedhjen në



**Berisha: Projektet e reja sigurojnë 30 mijë vende pune**

Në mbledhjen e Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, kryeministri Berisha theksoi se qeveria e tij mbetet e vendosur për të çuar deri në fund premtime për urbanizimin e zonave rurale. Sipas kryeministrit Berisha, "ky është një nga projektet më vendimtare për të bërë të mundur që pasuritë e shumta në mbarë komunat dhe territoret e Shqipërisë të mund të shndërrohen në

vlera për qytetarët e vendit". Shefi i qeverisë theksoi se 520 projektet e reja, që pritet të miratohen në mbledhjen e Komitetit, sigurojnë rreth 30 mijë vende të reja pune. "Jemi mbledhur sot për të miratuar së bashku rreth 520 projekte të reja. Këto projekte do të shtrijë në zonat rurale të vendit komunat, qarqet mbi 1200 km rrugë të reja. Investimi bën të mundur që qytetarët shqiptare

nga çdo skaj ku jetojnë të mund të kapin Tiranën, duke kursyer 70% të kohës që shpezojnë sot", tha Berisha. Duke vlerësuar rëndësinë e projekteve të tjera, për ndërtimin e 125 ujësjellësve të rinj, investimet në shkolla dhe ndërtimin e Qendrave Shëndetësore, kryeministri tha se në total të gjitha këto projekte, i japin një frymëmarrje të re procesit të punësimit.

**Flasin të "urtët" e PS**

**Brokaj: Presidenti do të zgjidhet me konsensusin e imponuar nga Arvizu**

■ ■ ■ TIRANE

Ish-ministri i Mbrojtjes dhe njëherësh Lanëtar në komitetin politik pranë kryetarit të PS Edi Rama, Sabit Brokaj është shprehur me tone jo fort optimiste në lidhje me vullnetin e partive politike shqiptare për arritjen e konsensusit për zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës që të përfaqësojë unitetin e popullit dhe të jetë garant i Kushtetutës së vendit. Për të, do të jetë ambasadori i SHBA, Alexandër Arvizu ai që do të vendosë në lidhje me konsensusin, duke e imponuar atë përpara se të fillojë procesi i votimit të kreut të shtetit. "Presidenti do të zgjidhet me konsensusin e imponuar nga ambasadori i SHBA Arvizu 48 orë ose 24 orë përpara votimit në raundin e



parë", ka qënë deklarata e fortë e Brokajt për gazetën "Shqiptarja.com". Një qëndrim të cilin shumë e mendojnë madje dhe e presin, por që pak e deklarojnë në

mënyrë publike. Dhe këtë qëndrim e ka mbajtur dje hapur njëri ndër të "urtët" e atashuar pranë kryetarit socialist Edi Rama. Por Brokaj nuk është mjaftuar vetëm me qëndrimin ndaj zgjedhjes së kreut të shtetit, por ka komentuar dhe takimin mes Ramës dhe Metës, takim i cili është argumentuar nga kreu socialist si një përpjekje për të arritur konsensusin për procesin e kriteret e zgjedhjes së Presidentit. "Takimi dhe dialogu politik mes politikanëve është element themelor i veprimtarisë së një lideri. E keqja është që në Shqipëri s'bëhet politike por intrigë. Kështu që ajo që do ishte fusha e politikës përbën një fushë me baltë të ndryrë, ku dhe lojtari që do të ishte i mirë paletëtar do të bëhej me këtë baltë që do binte erë", tha Brokaj.



**Dokumenti konfidencial i BE: Presidenti, simbol i unitetit të popullit**

**"Shqipëria të zgjedhë president konsensual"**

*Jo ndërhyrje në Prokurori, Kuvendi nën monitorim*

■ ■ ■ TIRANE

Më 15 maj, në Bruksel mbahet takimi i katërt i Këshillit të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri. Ndërkohë që është bërë publik qëndrimi i përbashkët të 27 vendeve anëtare. Pasi mirëpritet marrëveshja e nëntorit të kaluar, dokumenti konfidencial nis me këshillat ndaj klasës politike për vijimin e dialogut, zgjedhjen e presidentit sipas frymës së Kushtetutës dhe respektimit e institucioneve të pavarura. "BE nënvizon rëndësinë e një procesi të patrazuar për zgjedhjen e presidentit në përputhje me tekstin e frymën e Kushtetutës. BE vëren se sipas Kushtetutës, Presidenti përfaqëson unitetin e popullit dhe për këtë arsye zgjedhja e presidentit duhet të vijë pas një procesi gjithëpërfshirës diskutimesh dhe bashkëpunimi mes të gjitha palëve kyçe të interesuara", thuhet në dokumentin konfidencial të Bashkimit Evropian, të bërë publik nga ana e TCH. Njëherësh një rëndësi të dorës së parë të 27 vendet anëtare cilësojnë respektimin e institucioneve të pavarura të shtetit. "BE nënvizon rëndësinë e respektimit dhe mosndërhyrjes në punën e institucioneve të pavarura të shtetit si element kyç të demokracisë, përfshirë Presidentin dhe Prokurorin e Përgjithshëm", thuhet në dokumentin konfidencial. Pasi mirëpret votimin e disa ligjeve



**Gjyqësori**  
Ndër prioritetet e tjera kyçe, gjyqësorit i kushtohet vëmendja dërmuese, ku kërkohet progres i prekshëm për të garantuar besimin në sistemin e drejtësisë shqiptare, madje edhe ndëshkim të duhur për gjykatësit.

me shumicë të cilësuar, mënyrën si u zgjodh Avokati i Popullit dhe ngritjen e grupeve të punës për reformën zgjedhore dhe parlamentare. BE vijon me kërkesat për punën që mbetet për t'u bërë. Njëherësh në dokumentin e vendeve anëtare të BE që do të paraqesin më 15 maj kërkohet me insistim një dialog poli-

tik mes palëve. "BE kujton se është fillimisht përgjegjësia e udhëheqësve politikë shqiptarë të të gjithë krahëve të lënë mënjanë retorikat konfrontuese e duke u qëndruar në axhendën europiane, të punojnë me konstruktivitet në ndërtimin e një konsensusi për reformat e nevojshme. BE nënvizon se

suksesi i Shqipërisë në integrimin europian kërkon që ky proces të bëhet pjesë e axhendës kombëtare të vendit për qeverinë, opozitën dhe shoqërinë civile. Rrjedhimisht, arritja e progresit dhe dhënia e rezultateve në reformat kyçe duhet parë si përgjegjësi, por dhe si sukses i ndarë për qeverinë e

opozitën", thuhet në këtë dokument, me të cilin do të njihet dhe pala shqiptare gjatë këtij takimi. Njëherësh një vend të veçantë zë dhe reforma parlamentare. "BE mirëpret ngritjen e një grupi pune për ndryshimin e rregullores së Parlamentit dhe progresin e arritur deri më sot. Nënvizon rëndësinë e

plotësimit të qetë të procesit, bazuar në një konsensus ndërpartiak dhe të marrjes së masave për të garantuar zbatimin e vërtetë të rregullores", thuhet në deklaratë. Sipas të cilës, BE nënvizon se funksionimi i duhur i Kuvendit të Shqipërisë, prioritet kyç i opinionit, përfshin përmirësimin e performancës për sa i përket shqyrtimit të legjislatcionit dhe funksioneve mbikqyrëse. "Një parlament plotësisht funksional i bazuar në një dialog politik konstruktiv e të vazhdueshëm mes partive politike është thelbësor për demokracinë e Shqipërisë", thotë deklarata. Ndërkohë që BE bën thirrje për zhvillimin transparent dhe të rregullt të procedurave për dëgjimin dhe votimin e kandidatave për postet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Lartë. "BE kujton se reforma zgjedhore dhe mbajtja e duhur e zgjedhjeve janë prioritetet kyçe të Opinioneve. BE përsërit rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga OSBE/ODIHR dhe nga Komisioni i Venecias për të përmirësuar praktikën e së kaluarës dhe për të garantuar përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. BE nënvizon se plotësimi në kohë i reformës zgjedhore është element kyç i marrëveshjes politike të nëntorit 2011 dhe thelbësor duke patur parasysh zgjedhjet parlamentare të vitit 2013", thuhet në dokumentin konfidencial të BE.



## Gara për kreun e FRESSH, kandidatët poster të përbashkët



Socialistët e rinj tekna kanë nisur zyrtarisht nisjen e fushatës për zgjedhjen e kryetarit të ri të FRESSH që më 5 maj, tashmë të rinjtë socialistë kanë prezantuar posterin e fushatës, që do të kurorëzohet në përvjetorin e themelimit të PS. Janë 6 të rinj që do garojnë për postin e kryetarit të FRESSH, duke u

mbështetur tërësisht në modelin amerikan. Që konsiston në një fushatë në të cilën të kandidatët e prezantuar më 5 maj, përmes takimeve në 36 rrethet të vendit do marrin mbështetje për ta përdorur më pas në ditën e caktuar me zgjedhjen e kreut të ri të FRESSH. Që do jetë pikërisht njëri nga të rinjtë

që do grumbullojë më shumë mbështetje. Kandidatët në garë janë Artur Micko, Elisa Spiropali, Erlis Hoxha, Joleza Koka, Juxhin Çela e Maria Myrindina. Sekretari për Rininë dhe Emigracionin, Erion Veliaj deklaroi kohë më parë se gara për kreun e ri të FRESSH do përfundojë më 12 qershor.

Kryetari i PS flet për takimin me Metën dhe firmat për Nanon: Duam vetëm dakortësi

# Rama: President, jo nga figurat e PD dhe të PS

Kreu socialist: Kundërshtarët s'i konsideroj armiq, takoj Berishën

## Lajmi

Kryetari socialist Rama është shprehur se iniciativën e tij të takimeve me liderët kryesorë të politikës e ka ndërmarrë për të garantuar një proces të zgjedhjes së presidentit sa më konsensual dhe përfaqësues të unitetit të popullit. Ai nuk e mohon takimin me Metën, por thotë se do takojë dhe Berishën.

qysh se jam në krye të PS. Është shumë e rëndësishme të kuptohet që procesi ku kemi hyrë imponon një komunikim dhe krijim të një klime besimi, duke komunikuar me kundërshtarët. Kur ndërmarr një nisje të tillë politike me këtë qëllim madhor, marrim përsipër të shohim të ardhmen.

**Ju keni keni mbajtur qëndrim të ndryshëm për videon e Metës. Mendoni se është i korruptuar, vendimi i drejtësisë i gabuar...?**

Sëpari ardhja ime është një hap për të parë gjërat me syrin e së ardhmes dhe për të mos ngatërruar as historinë në çështjet që duhen zgjidhur sëbashku në interesin kombëtar dhe as qëndrimet që unë ua përsëris janë qëndrime politike të mbajtura gjatë gjithë periudhës sime si kryetar i PS. Së dyti në rast se në përpjekjen për të vendosur paqen në I. Veriut palët që kishin jo vetëm qëndrime për të kujtuar njëri tjetrit në konferenca shtypi, por dhe shumë e shumë lista të vvarësish dhe më shumë, sipas jush duhej të uleshin për t'u marrë me tërë ato ngarkesa dhe mbingarkesash që mbartnin, apo duhet të uleshin për të kërkuar zgjidhje jo në funksion të njëri tjetrit, por të njerëzve që përfaqësojnë. Së treti, është dita për të kërkuar rrugën e së ardhmes, duke i ndarë betejat politike me betejën për aspiratën e një populli të tërë që përfaqësojmë. Do takohem dhe me Berishën, pavarësisht se është ai që është.

**Po me Berishën po por...?**

Atëherë përse na qenka gabim të takohem me Metën. Jemi përfaqësues

**"Kur ndryshuam Kushtetutën kisha parasysh shembullin e vendeve të tjera, që nuk i referohen 71 votave gjashtë muaj para siç bëjnë Berisha, por gjejnë rrugën e dakortësisimit"**

të të njëjtit popull që s'është i ndarë në aspiratën e tij.

**Për Metën, drejtësia veprimi mirë...?**

Unë në konceptimin tim nuk di të shaj. Jua përsëris që unë fola për një situatë që e imponon përpjekjen për bashkëpunim, por nuk fola për rrugë rozë, ku politika do pushojë



së bëri politikë.

**Por jeni takuar...?**

Nuk ka pasur takim në mesnatë. Ka pasur një takim jo të hapur për publikun, por pas një ftese publike. Për një proces që s'vendoset numerikisht por me bisedim. Paqja vendoset me armiqët, por Meta e Berisha s'janë armiq, por kundërshtarë. Kjo s'është nënkupton rishkrimin e historisë, as me një natyrë morale diskutimi, që s'kanë lidhje me këtë. Unë jam kundër korrupsionit e drejtësisë s'duhet të mbyllë këto çështje.

**Por duhet të marrin fund akuzat, dhe pajtimet...?**

Unë them se besoj që Shqipëria mund të bëhet, meriton më shumë, dhe që pa asnjë dyshim jemi të gjithë në që duhet të bëjmë më shumë. Unë jam gati që dhe në këtë rast të tregoj nga pozita e kryetarit të opozitës sot, atë që do bëj në pozitën e kryetarit të qeverisë nesër. Nëse sot është çudi që takohet kryetari i opozitës me kryeministrin apo me kryetarin e një partie të koalicionit, kur unë kur të jem kryeministër, një nga gjërat e cila do të jetë prioritet në politikën tonë të komunikimit, do jetë vendosja e kontakteve normale, publike dhe jobpublike me kreun e opozitës, opozitarët që në fund të fundit janë shqiptarë dhe përfaqësojnë të njëjtë shqiptarë.

**I keni kërkuar falje Metës...?**

Kjo është një tjetër pyetje që buro nga cikllit sajo, boto e pyet për atë që ke sajuar. S'kam asnjë problem për kulturën dhe edukatën time, që e kam marrë prej gjuhës sime katolike, të kërkoj falje, sepse me kryetarin e LSI s'takohem të rishkruaj të kaluarën por të ardhmen dhe si

kundërshtarë. Pasi ka momente historike kur gjërat zgjidhen sëbashku.

**Akuzat respektive kanë qënë të forta...?**

Kjo është një histori që shpresoj të mbarojë dhe nuk na ndihmon vazhdimi pa ndërprerje as kur realisht Shqipëria vihet në provë, dhe nuk vihen në provë ata që vuajnë shumë, vihen në provë përfaqësuesit e tyre.

**Ka emër të përveçëm për Presidentin...?**

Ne e kemi bërë të qartë që duhet një proces, që nga procesi të shkojnë në një emër të dakortësuar mes palëve.

**Jashtë apo brenda politikës...?**

Nuk është kusht që presidenti të zgjidhet në një sallë me 140 vetë, që nuk ka jashtë tij një kandidat që të jetë president. Kemi vënë një kusht që presidenti të mos jetë nga radhët e PD.

**Ratë dakort me Metën për këtë...?**

Dhe ky është një spekulim. Ne nuk mund të pranojmë si figurë për një proces të dakortësuar asnjë nga figurat e PD, ashtu sikurse nuk pretendojmë të imponojmë asnjë nga figurat e PS.

**Ju kërkuat ndryshimin e Kushtetutës. E pengon Kushtetuta PD ta zgjedhë presidentin...?**

Nuk e pengojmë dot palën tjetër të bëjë një aventurë në kushtet në të cilat po flasim, sepse jemi në momentin historik pasi në vjeshtë kemi provimin për herë të tretë.

**BE e SHBA thonë...?**


Ata thonë se nga mënyra si zgjidhet

**"Në debatin e fundit përpara garës presidenciale në Francë Sarkozy iu drejtuar rivalit të tij me një fjalë: Ju jeni një shpifarak i votës. Pak ditë më pas, ishin bashkë"**

presidenti varet gjykimi i mëtejshëm për integrimin. Presidenti mishëron unitetin kombëtar e garanton disa institucioneve kushtetuese që ne s'lejojmë që të bien në dorën e kryeministrin nga skifteri e Berishës. Merkel i kishte votat, por e zgjidhi nga opozita.

**Në 92-97, 97-2002 dhe 2007-2012 u zgjodhën presidentë me**

Takim privat me Saliun? Privatist takoj debat para shqiptarëve.



**përfaqësues politikë...?**

Në periudhën e parë 1992-1997 e patëm vërtet simbol të unitetit të popullit. Më '97 patëm një president i arësyes, ndërsa më 2002 një president tamam simbol të unitetit të popullit.

**Topi ka votuar për ju...?**

Ky është një tjetër moment trishtimi. Eshhtë hedhur një fletë në kutinë e gabuar e paska pasur vetëm një fletë. E vërteta është se aty janë hequr disa fletë e paska mbetur vetëm fleta e Topit. Fakt që në Tiranë i fituan me, ato u transformuan në KQZ.

**Nëse nuk arrini konsensus, do merrni pjesë në votim...?**

Kjo është taktikë, strategjia është pa 'nesër' e 'silkur', duam një president që nesër të gjithë të ndjehen mirë. Që Shqipëria të japë një provë se është në gjendje të garantojnë stabilitetin.

**Do kërkonti kushtetuese korrumin...?**  
Jo. E kemi thënë njëherë.

**Do të jepni 20 firma për Nanon...?**

Nëse jemi të angazhuar për dakortësi, nuk do bëjmë atë që do bëjnë Kryeministri.

**Keni biseduar që Meta të jetë president...?**

S'kemi bërë bisedë të natyrës konsiprative, por për të parë pikat e përbashkëta.

**Do ti mbyllni universitetet private...?**

Do vendosim një sistem ndërkombëtar akreditimi, që do kalojnë të gjitha në sitë.

**Por them që...?**

Do kisha shumë dëshirë të kisha këtu Berishën që të debatoja.

■ ■ ■ TIRANE

Kryetari i PS në emisionin "Opinion" në TV Klan është shprehur se me Metën ka biseduar për të ardhmen, duke pohuar se takohet dhe me Berishën, madje dhe bën debat publik. Ai tha se është për një president konsensual dhe jo nga PD, që që e kërkojnë e partnerët ndërkombëtarë. Ndërkohë që pranoi se s'ka firma për Nanon por dhe ka thënë se president s'duhet të jetë asnjë nga figurat e PD e PS

**Çfarë keni deklaruar në takimet me liderët politikë dhe...?**

Shprehja gjithë shqetësimin serioz që unë kam për të krijuar kushtet që Shqipëria të ketë një president që të përfaqësojë unitetin kombëtar, që ti japë udhë aspiratës sonë evropiane, sepse bëhet fjalë për një provë që do përcaktojë qartë fatin e provimit tonë të vjeshtës së ardhshme. Unë do bëj çmos që Shqipëria të mos mbesë për herë të tretë.

**Ka akuzë se ka pasur një takim në nëntor 2011 me Metën në Bruksel...?**

Informacionet tuaja janë të kontestueshme sepse vijmë nga një burim. Kemi shumë informacione, por janë të pabesueshme.

**Takimi me Metën, ka problem moral pasi janë hedhur disa akuzë të ndërsjella...?**

Së pari unë nuk jam takuar me Metën për të rishkruar të kaluarën. Qëndrimet e mia si kryetar i PS në këto momente dhe në momente të tjera të caktuara, janë të mbajtura në rrethana të qarta dhe janë pjesë e historisë. Unë vetë s'ndiej asnjë arsye që të ndjehem keq për gjithçka që kam thënë

## Gjykata e Lartë: Çështja Prifti-Beqiraj do të vazhdojë

Gjykata e Lartë vendosi dje të vazhdojë procesin e gjykitimit ndaj ish dy zyrtarëve të lartë Dritan Prifti dhe Leonard Beqiraj duke rrezuar të 7 kërkesat e palës mbrojtëse të cilat kishin në thelb pushimin e çështjes. Trupi gjykyes me relatorë Mirela Fana dhe gjyqtarët Fatos Lulo, Arjana Fullani, Aleksandër Muskaj dhe Gani Dizdari, i kanë dhënë përgjigje negative të 7 kërkesave të mbrojtjes. Është

rrezuar kërkesa për pavlefshmëri të provave, për pavlefshmëri të akteve dhe dokumentave, për pavlefshmëri të akteskëprtimeve, për pavlefshmëri të regjistrimit të procedimit penal. Sipas Gjykatës së Lartë regjistrimi i procedimit penal është kryer sipas kodit të procedurës penale. Gjykata e Lartë rrezoi dhe kërkesën e fundit atë për pushimin e gjykitimit ndaj dy ish zyrtarëve të akuzuar për korrupsion

pasiv pas publikimit të video përgjimit Prifti-Beqiraj. Mbrojtja kërkonte pushimin e çështjes me pretendimin se akt-kspertimi i kryer nga eksperti amerikan në procesin ndaj ish zy kryeministri Meta është i pavlefshëm dhe për pasojë të gjitha aktet që rrjedhin prej tij janë të pavlefshme. Pas scancës reagoi avokati mbrojtës i Dritan Priftit, Fatmir Braka. Sipas Brakës vendimi i sotëm i Gjykatës së Lartë ishte i padrejtë.



Në foto: Kreu i Partisë Socialiste, Edi Rama mbrëmë në "Opinion"

# Intervista e deputetit të PS-së, Ben Blushi Kundër Berishës, koalicionin me LSI

## Nëse parlamenti nuk zgjedh presidentin, qeveria bie

TIRANE

Deputeti i PS-së, Ben Blushi, në një intervistë për UTV deklaroi mbrëmë se PS-ja do të bashkëpunonte sërish me LSI-në, me qëllim që të rrezojë Berishën nga pushteti

**Z. Blushi, do të pranoni në koalicionin Ilir Metën, ndjestë pastë sipas jush?**

Sigurisht që po, s'kam asnjë dilemë për atë, pavarësisht se çfarë ka ndodhur. Në eventualisht mund të kemi një koalicion me LSI. Nëse ka një gjë që stonon është aleanca e PD me LSI, kurse aleanca PS dhe LSI, pavarësisht se çfarë është folur është një marrëdhënie organike. Është bashkimi i trupave që u ndanë dhe u bashkuar, është biologjike, se me sa duket është koha. Mund të ishim të gatshëm, ky është një proces që sa ka filluar, është i pritsëm, por është edhe i mundshëm. Ata që nuk e kanë parashikuar këtë tregon se nuk kanë pasur fantazi.

**E përkrahni ju këtë gjë?**

Ne jemi një parti e madhe, e cila ka dalë nga disa eksperiencat të vështira elektorale, 2005, 2007, jo zgjedhjet lokale ndoshta shumë, 2009, 2011, duhet të jemi realist të them se për shkak se disa eksperiencat stresuese koha na treguar se duhet të jemi më tepër. Aleanca e munguar me LSI na çoi në rezultatit e keq në 2009, mungesa e koalicionëve të mjaftueshme numerike jo porogamorre na con në rezultatit e 2009, mbi këtë bazë arsyetimi mund të ndodhi. Nëse unë e kam thënë për arsye racionale se PS duhet të kërkojë aleancat me votuesit se sa me partitë aktuale.

**Po mos është vonuar ky takim, mos ndoshta duhet të ishte më herët? Mos ishte me detyrë përcaktimi?**

Unë e kam të pamundur ta them. Një takim nuk është një marrëveshje. Por padyshim palët kanë interesa të përbashkëta për të arritur zgjedhjen për Presidentin. Në 2009 Ilir Meta na kërkoi një përfaqësi tjetër të Kodit Zgjedhor, por nuk e bëmë, ndoshta i humbëm zgjedhjet edhe për shkak të Kodit, por edhe të koalicionit. Takimi për Presidentin detyron palët nëse duhet nga vota. Nëse nuk do ishte presidenti, nuk do ishin as takimet.

**Nëse nuk do të ndodhte ekstremizmi, do ishte qasje më parë?**

Unë besoj se PS është më e rëndësishme, sot se para një viti. Ajo që ne kërkuam nuk ndodhi për shkak të radikalizimit, i cili solli shumë pasoja. Kur ne ishim në grevë nuk mund të afroheshim me parti. Tani që jemi në parlament normale që mund të egzistojë



marrëdhëniet dhe marrëveshjet.

**Çfarë faktori është Meta?**

Faktori i rëndësishëm numerik është LSI, pasi mban Berishën e mban në këmbë. LSI deri në fund duhet të bashkojë vullnetin me PS, për të mbrojtur presidentin. Rasti i presidentit dështoi herën e kaluar. Për zgjedhjet e 2009, për 21 janarin nuk mbajti një qëndrim. Nuk ka dështuar Topi, por presidenti që e zgjodhi Berisha. Ne nuk duam ta marrim presidentin por duhet ta mbrojmë e ta ndajmë, ndërsa ai do ta marrë dhe mos e ndajë.

**Procesi është garë apo nuk është garë? Ku është rreziku meqë po flisni për kandidaturë nga PD dhe PS?**

Nuk flasim për një, që do të bëjë në të ardhmen një gjë që nuk e dimë (e ka fjalën për emrin konkret, nëse do të propozohet). Berisha ka precedent me abuzimin e pushtetit. Ka precedent që prek votat, rremben gjykatat, rrembon ekonominë. Ne kemi arsye e fakte që Berisha abuzon me pushtetin që merr. Rrezikshmëria është që Presidencia të mos jetë në dorë të Berishës. Po kërkojmë aleanca për të zgjedhur Presidentin.

**Si i kërkon numrat?**

Nëse kemi një program të mirë, nëse kemi instrumentat e duhura, dhe filozofinë e duhur për të mos shtyrë në kohë edhe integrimin. Teknologjia e të bërit politikë ka ndryshuar. Ajo është e ndryshme e para 4 viteve. Parimi në këtë rast është se për momentin mund të kenë pika të përbashkëta për Presidentin, nëse ndodh një koalicion më vonë, por sot mund të ndërroje një praktikë me LSI. Në 2006 kam kërkuar president nga populli.

**Nano mund të prononcohet nga Rama?**

Kjo gjë rezulton çdo ditë edhe më e pamundur. Ne kemi kërkuar proces, ky i fundit garanton statusin. Të gjitha këto e kanë shtyrë statusin në tre vitet e fundit. Presidenti kur del nga konsensusi, Shqipërisë i jepet si bonos integrimi.

**E kundërshtoni Metën për**

**President?**

E kundërshtojmë në parim një president ekskluzivisht të PD. E kundërshtojmë, nuk negojmë. Përjashtojmë çdo kandidat që propozon një kandidat të njëanshëm.

**Meta president?**

Jemi për proces në tavolinë.

**Bërisha e zgjedh dot Presidentin?**

E ka të pamundur që Berisha të zgjedh presidentin pa LSI

**Do realizoni aleancë me Metën për të rrezuar Berishën?**

Patjetër që ta rrezojmë Berishën.

**E bëni Metën kryeministër duke rrezuar Berishën?**

Nëse parlamenti nuk qeverion votat me koalicion, ai ka rënë dhe qeveria bie në Parlament. Nëse LSI del nga qeveria dhe mund të ndërtojë një aleancë me ne.

**A mund të votoni Metën?**

Duhet marrëveshja më e madhe për të shkuar këtu.

**Në rastin, siç pretendohet, çfarë do t'i sillni Shqipërisë?**

Një program.

**Edhe këtë program do ta zbatojnë të korruptuarit?**

Jo të bësh atë që shqiptarët kanë nevojë. Të trisë cilësinë e jetës, të hapë vendi pune. Një program i cili ja bën jetën më të lirë dhe nuk është atë që shtrënjtë, nëse garantojmë këtë nuk ka rëndësi individit.

**Tre vite gabime, një vit do bëni mrekulli?**

Pse duhet të merrni këtë, nuk është matematika. Fëmija qëndron nënë të muaj në barkun e nënës, ato që s'i kemi bërë për tre vjet i bëjmë edhe brenda një viti.

**Do blini vota?**

Jemi për të bërë aleancë jo për të blerë vota. Trafiku i 2009 të votave nuk mund të ndodh tani.

**Rikthimi i Metës në të majtë?**

E kthyet vetë përgjigjen. Ai mund të kthehet në të majtë, dhe jo në PS. Në 2003 e ka bërë zgjedhjen në jetën e vet, i ka qëndruar dhe i ka rezultuar kohës, sepse sot është kthyer në një njeri që të sjell në pushtet, ose të nxjerr nga pushteti.

**Çfarë i ofroni LSI?**

Nuk është qëllimi jetik. Ne nuk e dimë se çfarë do të bëjë LSI për presidentin nëse do të votojë një kandidat të Berishës. Meta kërkon një president më konsensual se Berisha.

EDITORIAL

NGA ANILA BASHA

## Rama & Nano vs Berisha & Blushi?

vijon nga faqja 1

...ndonjë gjë të madhe, dhe Blushi mund të thoshte shumë të tilla, ashtu sikurse në fakt ndodhi. Kjo tregoi edhe njëherë se kafia që Rama e Blushi konsumuan në barin e PS shumë muaj më parë, ka qenë thjesht një "zhgënjim optik", pa pasur ndonjë jetëgjatësi në marrëdhënien mes dy palëve.

Po e njëjta gjë ndodhi edhe në takimin e përfolur me pritsshmëri të mëdha Berisha-Nano. Kandidati i vetëshpallur për president, nuk ka hezituar në asnjë rast që të kthejë përgjigje për pyetjet e gazetarëve sa herë që këta ia kanë kërkuar, pas takimeve që ka konsumuar duke kërkuar pozicionin e kreut të shtetit. Por ja që dje pas takimit me Berishën nuk ndodhi. Ky i fundit, nëpërmjet një deklarate për shtyp, vendosi të eklipsonte Fatos Nanon, duke i thënë gjithë publikut se Nanon e pret në zyrën që kishte që nga 2005 që nuk kishte hyrë, por si një mysafir të radhës, pa e marrë seriozisht kërkesën e tij për president. Nano vetë, i njohur për stilin e tij të batutave, doli i nervozuar nga takimi. Sigurisht, në takimin e parë me Berishën, nuk mund të prishte mirëkuptimin e tij për të qenë ish lideri i së majtës kandidat për president, edhe pse, në 2007, nxitoi me vrap t'i jepte Berishës mbështetjen për zgjedhjet lokale kur i kërkoi.

E pavarësisht këtyre analizave të takimeve dhe daljeve publike të djeshme, ajo që ra në sy, është linja mediatike e përcjelljes së transmetimeve. Skema ishte e qartë. Ishte Rama & Nano në audiencat e tyre, kundrejt Berishës & Blushit me një tjetër audiencë. Në politikë, siç thonë politologët, shumë rrallë ndodh të ketë koincidenca, ka vetëm planifikime. Dhe unë besoj, se aktiviteti i ditës së djeshme, i përket vetëm planifikimit.

www.shqiptarja.com



## Balla akuzon Bashën: Ndhimove mikeshën personale



Deputetët socialistë akuzuan për mungesë transparence në dhënien e kredive dhe të banesave sociale për njerëzit në nevojë. Duke iu referuar kryetarit të Bashkisë së Tiranës, deputeti socialist Taulant Balla tha se "pak javë më parë pamë ai shpërbleu me kredi strehimi të akuzuarin

për vrasjen të 21 janarit apo mikeshën e tij personale. Kreditë për strehim duhet tu jepen atyre që e meritojnë, nuk ka pse kryetari i bashkisë të japë kredi njerëzve që ka marrëdhënie personale". Në fillim të prillit në shtyp u njoftua se në listën e personave që përfitojnë kredi të

buta për shtëpi në Tiranë rezultonte edhe emri i familjarëve të Agim Lluos, njeriut që është në burg për vrasje për ngjarjet e 21 janarit 2011, si dhe emri i të atit të Esmeralda Mulaj, këshilltarja për shtyp e kryebashkiakut Basha, dikur sipikere në TVSH.

Deputetët me dy-tre diploma dhe grada të larta shkencore

# Kuvendi, të gjithë juristë dhe "doktorë"

Emrat e deputetëve dhe titujt që morën

■ ■ ■ TIRANE

ARBEN RROZHANI

vijon nga faqja 1

... udhëheqës të temës juristin e njohur dhe anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, Xhezair Zaganjori. Zonja Topalli nuk e ka bërë publike doktoratën e vet dhe ajo është kyçur në arkivin e Fakultetit Juridik në Tiranë. Por kryetari e Kuvendit nuk është e vetmja. Në sallën plenare të Kuvendit, shumica e deputetëve të legjislaturës aktuale janë me dradën shkencore "Doktor". Shumica e ka marrë atë vitet e fundit, duke iu shtuar titujve të tyre shkencorë.

Rritja e tyre profesionale, në shumicën e rasteve, ka ndodhur vitet e fundit, në kohën që ata kanë qenë të zënë me angazhime shumë të mëdha politike, duke ushtruar mandatin e tyre të deputetit. Siç mund të shihet edhe nga lista e mëposhtme, deputetët, kanë marrë edhe diplomat për juristë, duke ua shtuar këto studime të mëtejshme, diplomave të mëparshme:

**Jozefina Çoha Topalli** (49 vjeç)-Mbaroi studimet e larta në Matematikë dhe Drejtësi në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Studioi për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Padovës, në Itali dhe u diplomua për master "Administrim publik" dhe master në "Studime europiane" në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2010 merr gradën shkencore "Doktor".

**Arben Ahmetaj** (43 vjeç) M.A. Tregti Ndërkombëtare dhe Diplomaci Patterson. Universiteti Kentucky, SHBA, Diplomuar dhjetor 1996. B.S. Universiteti i Tiranës, Shqipëri.

**Enkeled Alibeaj** (39 vjeç) 1993-1997: Diplomohet në Fakultetin e Drejtësisë 2000: Merr titullin "Magjistër", në Shkollën e Magistraturës.

**Ledina Alolli** (37 vjeç) 1993-1997: Universiteti "Fan S. Noli", Fakulteti i Ekonomisë, Dega Marketing. 2003-2005: Universiteti "Neofit Rilski" Blagoevgrad, Bullgari. Master Administrim-Biznesi, MBA 2005-2009: Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik. Grada "Doktor i Shkencave Ekonomike".

**Ndriçim Babasi** (45 vjeç)-2002 Akademia e Rendit Publik, Doktor i Shkencave Policore.

**Taulant Balla** (35 vjeç)-Studimet e larta dhe ato pasuniversitare në degën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin "Al.I.Cuza", Iasi - Rumani. Eksperienca studimore në disa qendra universitare në Konstanz, Londër dhe Paris. Doktoraturë në Shkencat Politike.

**Besnik Baraj** (56 vjeç)-Shtator 76- qershor 1981: Kryer studimet në FSHN, dega Kimi In-



Sarkazma e deputetit Harasani me diplomën e "Kristal"

dustriale. 1988: Doktor i Shkencave 1994: Prof. i Asociuar 2001: Profesor

**Astrit Beci** (46 vjeç)-1984-1989: Fakulteti Mjekësi e Përgjithshme, Universiteti i Tiranës. 1999-2001: Master në shëndet publik, shkolla kombëtare e "shëndetit publik".

**Ilir Bejtja** (46 vjeç)-1984-1988: Universite-

ti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Biznes. 2010-2012: Universiteti "Aleksandër Moisiu" i Durrësit, Shkolla e Doktoraturës Doktor i Shkencave Ekonomike në Profillin Marketing.

**Marko Bello** (51 vjeç)-1981-1985: Diplomohet në degën Gjuhë Frënge, në Fakultetin Histori-Filogji, Universiteti i Tiranës.

1985-1987: Kurs pasuniversitar për Diplomaci, Universiteti Shtetëror Tiranë. 1997-2000: Doktor i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Fakultetin e Drejtësisë "Nicolae Titulescu", pranë Universitetit Shtetëror të Krajovës, Rumani.

**Sali Berisha** (67 vjeç)-Në vitin 1989 iu dha titulli Profesor në Universitetin e Tiranës.

**Luçiano Boçi** (45 vjeç)-1985-1989: Universiteti "A. Xhuvani", Elbasan, dega Gjuhë-Letërsi. 09.07.2004: "Doktor i Shkencave"

**Ridvan Bode** (53 vjeç)-1979-1983: UB Tiranë, diplomuar Financier i Lartë. 1992-



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA DURRES



Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 2/223 10, e-mail: info@Dures.gov.al

"Ne zbatim te Nenit 7 dhe 44 te Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligji nr.7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes se Republikes se Shqiperise" i ndryshuar, Ligjin nr. 9840 date 10.12.2007 "Per ratifikimin e Marrveshjes kuader ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Komisionit te Komunitetit Europian per rregullat e bashkepunimit per asistencen per Shqiperine ne kuader te zbatimit te instrumentit para aderimit IPA, Ligji nr.10152 date 28.09.2009 "Per ratifikimin e Marrveshjes se Financimit ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Komisionit te Komuniteteve Europiane per Programin e Bashkepunimit nderkufitar Adriatik te instrumentit para aderimit IPA Komponenti II- Bashkepunimi Nderkufitar per Shqiperine" dhe Marrveshjes se bashkepunimit "Partnership Agreement" nr. 049 2009 midis Partnerit Lider (Mesagne (Brindizi) Itali) dhe Partnerve perfitues (Bashkia Durres FB6) dhe Urdherit te Kryetarit te Bashkise nr.61 date 07.05.2012.,

### BASHKIA DURRES SHPALL KONKURS TE HAPUR

Bashkia Durres shpall Konkurs te hapur per perzgjedhjen e nje eksperti ne fushen e agrokultures dhe politikave agrare, ekspert i cili do te kontraktohet nga Bashkia Durres me kohe te pjeshme ne emer te projektit TURGRATE 2 per nje afat kohor te percaktuar ne projekt sipas procedurave te vleresimit qe percaktohen nga "Kodi i Punes" i Republikes se Shqiperise dhe kriteret e percaktuara ne "Manualin e menaxhimit dhe kontrollit te programit". Te gjitha te interesuarit jane te lutur te therhejnin dokumentacionin e konkurimit duke filluar nga data 14.05.2012 ne "Njesine e Menaxhimit te Projektit TURGRATE 2" ne Drejtorine e Politikave te Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit prane Bashkise Durres ne adr. Lagjia Nr.3, Sheshi "Liria" Durres. Afati i fundit i dorezimit te dokumentacionit eshte date 08.06.2012. Dorezimi do te behet prane Komisionit te Vleresimit me date 08.06.2012, ora 10.00 prane Bashkise Durres ne adresen e mesiperme. Per cdo hollësi e sqarime te metejshme kontaktoni me Drejtorine e Politikave te Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ne Bashkine Durres".



1995:Përfundon ciklin e thelluar të studimeve pasuniversitare në Montpellier, Francë dhe fiton titullin "Master of Science", në opsionin "Kërkim shkencor" me vlerësimin "Cum Maxima Laude".

**Majlinda Bregu** (38 vjeç)-2001-2004: 1992-1996: Diplomë në Shkencë Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Doktoraturë, Universiteti i Urbino, Itali në "Sociologjia e fenomeneve kulturore dhe procesit normativ".

**Astrit Bushati** (50 vjeç)-1996: Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik. 2002: Kolegji i Mbrojtjes në Akademinë e Mbrojtjes.

2003: Master në "Administrim Publik", Fakulteti Ekonomi.

**Aurel Bylykhashi** (46 vjeç)-1990-1995: Universiteti Politeknik i Tiranës, dega Inxhinieri Mekanike. 1995: Specializim për Diplomën e Inxhinierisë në Universitetin Politeknik të Bari, Itali. 2004: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dega Juridik.

**Ramiz Çobaj** (51 vjeç)-1981-1985: Universiteti Bujqësori i Tiranës, Fakulteti Ekonomik. 1994-2000: Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Fakulteti i Drejtësisë. 1993-1997: Akademia e Lartë e Rendit, Tiranë.

**Ded Dedaj** (43 vjeç)-1990-1992: Akademia e Rendit, Instituti i Policisë, Tiranë. 1992-1995: Instituti i Kulturës Fizike, Tiranë. 2003-2007: Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës.

**Leonard Demi** (58 vjeç)-1986: Universiteti i Elbasanit, dega "Gjuhë-Letërsi". 1992: Gradën "Doktor i Shkencave".

**Tom Doshi** (46 vjeç)-2005: Universiteti Shtetëror i Tetovës, dega Juridik.

**Besnik Dushaj** (43 vjeç)-1997: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër. 2007: Studime pasuniversitare "Master në Drejtësi", Universiteti i Prishtinës

**Jemin Gjana** (52 vjeç)-1971-1975: Fakulteti Ekonomi Agrare. 1988-1990: Master në Ekonomi Agrare.

**Eglantina Gjermeni**-1986-1990: Diplomë në Histori, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. 2002-



## Skandali i diplomave, pyetet rektori Skënder Koçuku

Rektori aktual i universitetit "Kristal" Skënder Koçuku është marrë në pyetje nga prokuroria e Tiranës, lidhur me skandalin e paisjes me diplomë false të italianit Renzo Bossi. Në orët e paradites së djeshme Koçuku është paraqitur para hetuesve të çështjes duke dhënë sqarime rreth këtij skandali. Mësohet se gjatë dëshmisë së tij Koçuku ka përjashtuar

mundësinë e kryerjes së studimeve nga shtetas italianë në universitetin "Kristal". Ai ka pohuar se në periudhën kur është lëshuar diploma ai nuk ka qënë rektor i këtij universiteti dhe për pasojë nuk ka dhënë asnjë detaj mbi mekanizmin e kryerjes së kësaj procedure, pasi nuk kishte dëjani. Rektori Skënder Koçuku ka shpjeguar vetëm mënyrën e lëshimit të diplomave në rastet

kur shtetasit janë të huaj. Ai i është referuar vetëm disa rasteve nga Kosova dhe Maqedonia që studjojnë në këtë universitet por asnjë rast nga Italia. Pritet që në ditët në vijim prokuroria e Tiranës të marrë në pyetje dhe persona të tjerë, ku mes tyre janë rreth 30 pedagogë të këtij universiteti si dhe sekretaren që ka bërë regjistrimin e Bossit në universitetin "Kristal".



2005: Doktoraturë në Punë Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tema e doktoraturës- "Migrimi femëror në Shqipëri".

**Adriana Gjonaj** (58 vjeçe)-Studime universitare në inxhinieri mekanike. Mbajtëse e titullit akademik "Profesor" në informatikë. Gradë shkencore "Doktor" në automatizim në Universitetin Politeknik të Tiranës.

**Ilir Gjoni** (50 vjeç)-1981-1985: Universiteti Shtetëror i Tiranës, diplomuar për Gjuhë-Letërsi Angleze, Tiranë  
2002- 2004: Shkolla Pasuniversitare e Marinës së SHBA, Monterey, CA Master në Çështje të Sigurisë Kombëtare

**Eduart Halimi** (40 vjeç)-1991-1995: Fakulteti i Drejtësisë Tiranë. Akademia e Policisë Tiranë, korrespondencë.  
1997-2000 Shkolla e Magistraturës, Tiranë.

**Ismail Hoxha** (53 vjeç)-1984: Inxhinier, diplomuar në Universitetin e Tiranës. 1996: Doktor i Shkencave, Universiteti "La Sapienza" Rome, Itali. 2007: Profesor, Universiteti Politeknik i Tiranës.

**Paulina Hoxha** (58 vjeçe)-1987: Diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, dega Histori-Gjeografi  
1997: Fiton gradën "Doktor". 2005: Fiton titullin "Profesor i Asociuar"

**Vasilika Hysi** (49 vjeçe)-1981-1985: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike, diplomuar në degën Drejtësi.1993- Eshhtë dhënë grada shkencore "Doktor".  
1999- Eshhtë dhënë titulli akademik "Profesor i asociuar", në fushën e drejtësisë.

**Kastriot Islami** (60 vjeç)-Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega "Fizikë Speciale". 1999: Merr titullin "Profesor". Studime post-doktorate, Universiteti i Giesenit, Gjermani.

**Gjovalin Kadeli** (48 vjeç)-Fakulteti Juridik "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Fakulteti i Shkencave Shoqërore: dega Marrëdhënie Ndërkombëtare.

**Ervin Koçi** (37 vjeç)- 1993 - 1997: Fakulteti Ekonomik Tiranë, dega Administrim - Biznesi. 1998 - 2005: Fakultetin Juridik Tiranë (korrespondencë).

## Çfarë shkruajnë në CV-të e tyre ligjvënësit

# Pesë deputetë juristë te "Kristal"

## Diplomë të freskët te universiteti i përfolur

TIRANE

Pas marrjes së mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, pesë prej ligjvënësve shqiptarë kanë nxituar drejt universitetit "Kristal" për të marrë diplomën e tyre të dytë. Në regjistrat e studentëve ndër vite të fakultetit juridik figuron se 5 deputetë shqiptarë janë diplomuar si juristë pranë këtij universiteti.

Lajmi është publikuar pas një investigimi të gazetës "IDEA". Deputetët janë Skënder Hasa (PS), Bedri Hoxha (PD), Ndue Paluca (PD), Rrahim Çota (PD), Artan Gaçi (PS). Sipas të dhënave që publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Hasa, pasi ishte diplomuar në Fakultetin Ush-tarak, ka marrë në vitin 2005-2007 diplomën e juristit në universitetin Kristal. Deputeti Hoxha, pasi ka qënë diplomuar për



mësuesi, ka marrë në vitin 2009 diplomën e juristit në universitetin Kristal. Deputeti Paluca, pasi ishte diplomuar në Universitetin Bujqësor në Kamzë, në vitin 2005-2008 ka marrë diplomën e juristit në universitetin Kristal. Deputeti Çota, pasi ka qënë diplomuar në universitetin Bujqësor në Kamzë, në vitin 2006 ka marrë diplomën e juristit në universitetin Kristal. Deputeti Gaçi- zgjedhur deputet në vitin 2009, pasi ka qënë

dipomuar në Institutin e Lartë të Arteve, ka marrë më pas diplomën e juristit në universitetin Kristal.(Në cv-në e deputetit Gaci nuk shënohet se kur e ka nisur dhe kur e ka filluar shkollën). Hoxha ka deklaruar vetëm kohën e diplomimit, Korrik 2009, dhe nuk ka shënuar se kur e ka filluar. Ndërkohë që deputeti Artan Gaci nuk e ka deklaruar në cv-në e tij në faqen zyrtare të parlamentit se kur e ka filluar dhe kur e ka përfunduar fakultetin.

## Shpërthimi i Renzo Bossit

# "Diplomë në Shqipëri? Nuk di asgjë"

Djali i senatorit: "Më akuzojnë vetëm për të më përdorur si një armë kundër babait, që po rikandidon"

MILANO

Unë distancohem krejtësisht nga ajo diplomë e shkollës së lartë. Nuk kam qënë kurrë në Shqipëri, nuk flas shqip, nuk kam pretenduar kurrë për kualifikime akademike dhe nuk pasur kurrë dëjani për këtë dokument që daton më 2010". Disa ditë pasi lajmi ka bërë xhiro në ëeb duke u kthyer edhe në barsaletë, renzo Bossi ka reaguar për herë të parë në lidhje me diplomën e marrë në Shqipëri, diplomë që u tjezt në kasafortën e ish-financierit të Legas, Francesco Bel-sito. "Sa i përket këtij fakti, - ka deklaruar renzo Bossi, - ne jemi në vitin 2012 dhe unë vetëm tani e mësoj këtë gjë: unë kurrë nuk kam thënë se kam një diplomë,

kjo të paktën duhet të jetë kuptimplotë për ju"- ka vijuar deklarata e djalit të Umberto Bossit e publikuar tek Ansa. Bossi hedh dyshime në lidhje me diplomën e marrë në Shqipëri, që doli nga dokumentet e sekuestruar nga prokurorët që po hetojnë llogaritë e Lega Nord, ish-këshilltari i Lombardisë madje ka shtuar se "sipas një analize të thjeshtë të këtij dokumenti mund të vihet re fare lehtë se edhe data e lindjes së tij është e gabuar, datë kjo jo pak e rëndësishme". Djali i Umberto Bossit ka shpjeguar: "Nuk kam folur deri më tani, sepse unë besoj tek gjyqësori dhe unë duhet t'i jap llogari vetëm atij, por jam i detyruar të bëj një sqarim publik, kundër vullnetit tim, për t'i thënë sop medias me këtë



Renzo Bossi

fushatë sulmesh ndaj meje, dhe atyre gazetave, që shumë herë gjatë këtyre viteve kanë marrë pozicionin e gjyqtarit" PO përdorem kundër babait- "kam parë dhe dëgjuar shumë persona që më akuzojnë padrejtësisht, vetëm për të më përdorur si armë kundër babait tim, duke u përpjekur t'i bëjnë shantazh dhe ta frikësojnë që të mos rikandidojë në postin e sekretarit federal" - ka deklaruar më tej Trofita. Renzo Bossi ka ngritur edhe "flamurin e bardhë" dhe kërkon të lihet në qetësi. "Kërkoj që të më lini të qetë, duke qënë se unë kam përbushur detyrimin tim duke dhënë dorëheqjen nga çdo post politik duke lënë Legën të lirë për të çuar përpara projektet e saj politike"

2002 - 2004: Master për Administrim Publik (MPA), pranë Fakultetit Ekonomik, Tiranë.

**Mimi Kodheli** (48 vjeç)-1982-1986: Fakulteti i Ekonomisë, Dega Financë, Universiteti i Tiranës. 2006-2010: Doktoraturë (PhD) në Ekonomi dhe Financa Ndërkombëtare, Universiteti i Veronës, Itali.

**Lefter Koka** -Arsimi i Lartë, Fakulteti Ndërkombëtar i Shkencave Juridike, Shkup.

**Ylli Lama**-Arsim i lartë, Juridik

**Agim Leka** (51 vjeç)-1971-1976: Studime në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, Dega Filozofi, Universiteti i Tiranës.

Diplomuar me Titullin: "Punonjës i shkencave politike dhe juridike". Regjistruar në Ciklin XXV "Dottorato Di Ricerca in Filosofia",

Universita Degli Studi Di Verona, Italy. Dekreto Rettorale nr 445/1/2009.

**Piro Lutaj** -1982- Akademia "Skënderbej", Tiranë. 2004- Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Drejtësisë.

**Pandeli Majko** (45 vjeç)-Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

**Arben Malaj** (51 vjeç)-Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Profesor i Asociuar i Shkencave Ekonomike. Senior Fellow, Harvard University, Center for Business and Government.

**Lefter Maliqi** (40 vjeç)-1987-1991: Shkolla e mesme ushtarake "Skënderbej" 1991-1993: Akademia e Forcave Tokësore "Skënderbej"

1993-1996: Akademia e Policisë Tiranë. Fakulteti Juridik.

**Mark Marku** (46 vjeç)-1990-1994: Diplomi-mi, në degën e Gjuhë-Letërsi, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë Universiteti i Tiranës. 2010: Doktor i Shkencave të Informimit dhe Komunikimit. Universiteti Pantheon-Assas, Paris 2, Sorbone, Francë.

**Ilir Meta** (43 vjeç)-Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Master për Integrimin Ekonomik, Universiteti i Tiranës.

**Osman Metalla** (48 vjeç)-1978-1982: Akademia e Detarisë, Vlorë. 1983-1986: Akademia e Marinës, Vlorë, Komandues detar. 2006-2008: Master, Administrim Publik, Fakulteti i Ekonomisë, UT.





**Durrës, bllokohet  
20 kg heroinë që  
vinte nga Maqedonia**

**B**llokohen në Durrës 20 kg lëndë narkotike të llojit heroinë. Lënda narkotike mësohet se kishte hyrë në teritorin Shqiptar nga Maqedonia dhe destinacioni i saj ka qënë Italia dhe tregu European. Sasia prej 20 kg drogë është kapur në portin e Durrësit, teksa kamioni i është nënshtruar procedurave të kontrollit. Mësohet se ka qënë qeni i antidrogës ai që

ka gjetur drogën e fshehur në pjesën e kamionit. Blutë e qytetit bregdetar arrestuan drejtuesin e mjetit, identiteti i të cilit nuk bëhet i ditur dhe nisën hetimet për të zbuluar persona të tjerë të përfshirë në këtë rrjet trafik. Personi i arrestuar është marë në pyetje nga efektiva të policisë si dhe specialistë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Operacioni i sekuestrimit të lëndës

narkotike ka qënë aksidental dhe se nuk është ndjekur me hetime disa mujore të prokurorisë apo policisë. Tashmë këto dy struktura janë duke hetuar me imtësi të gjitha kontaktet telefonike të shoferit të kamionit, i cili mendohet se ka qënë në rolin e korrierit ku për transportimin e sasisë së drogës do merte një sasi të kunsiderueshme financiare.

**Palestinezi është kërcënuar me vdekje nga banorët e tokës**

**Rizik mori kërcënime s' mbante bodigardë**

**Merren kasetat që shfaqin protestuesit në fabrikë**

**Lajmi**

Anwar Rizik, edhe pse marë kërcënime me vdekje nga banorët të zonës së Fushë-Krujës nuk kishte asnjë masë sigurie si drejtuesit e tjerë të fabrikës së çimentos. Mungesën e podigardëve e kanë shfrytëzuar më së mirë autorët e krimin, të cilët sipas prokurorisë këtë herë kanë vendosur të eliminojnë fizikisht një nga drejtuesit.

**TIRANE**  
ELTON QYNO

**N**dryshe nga drejtuesit e tjerë të fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë që mbanin prapa shpinës nga një ose dy podigardë, 43 vjeçari Anwar Rizik nuk kishte asnjë të tillë edhe pse kishte marë kërcënime të vashdueshme. Pavarësisht konflikteve dhe presioneve të banorëve të zonës ku ishte ndërtuar fabrika e çimentos, Rizik kishte zgjedhur që të qëndronte pa asnjë mbrojtje. Siç duket mungesën e sigurisë e kanë studjuar mirë dhe autorët e krimin, të cilët kanë zgjedhur ta eliminojnë fizikisht, babain e dy fëmijëve, duke hartuar planin që në dukje i ngjan atyre të grupeve terroriste. Sipas burimeve pranë policisë dhe prokurorisë së Tiranës dyshimet më të forta janë mbi anëtarët e disa familjeve, ku mbi pronat e të cilave është ndërtuar fabrika. Ndërsa për sa i përket pistave të tjera, prokuroria bëri me dije se ato janë të përjashtuara, për shkak se dhe viktimata nuk ka pasur asnjë lidhje me grupe terrorizmi, konflikt për konkurrencën e biznesit apo diçka më tepër se kaq. "Ne jemi të përqëndruar vetën në Fushë-Krujë, pasi kemi disa raste të njëpasnjëshme ku me të njëjtin mekanizëm janë hedhur në herë, ambientet e fabrikës, shtyllat e energjisë, automjetet, linjat hekurudhore si dhe hekurudhat. Kaq na mjafton që i gjithë hetimi të përqëndrohet në këtë zonë dhe askund tjetër"- thanë burimet pranë prokurorisë së Tiranës. Këto të fundit thanë për gazetën "Shqiptarja.com", se autorët duke shfrytëzuar dhe mungesën e bodigardëve, kanë studjuar mirë viktimitë, të cilën arriten ta vrisnin po me të njëjtin mekanizëm, siç dhe kanë



Anwar Rizik

bërë atentatet e tjera. Prej vite me rradhë zv/drejtori i fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë si dhe shefi i financave Anwar Rizik nuk kishte asnjë mbrojtje, edhe pse gjatë protestave të bëra nga banorët kishte marë kërcënime për vrasje. **PROTESTAT KËRCËNUESE**

Sipas informacioneve operative të mblendhura nga

agjentët e policisë së Tiranës, banorët të fshatrave, Picrakë, Zall dhe Kadias gjatë protestave të tyre kanë kërcënuar me jetë drejtuesit e fabrikës së çimentos, në rast se ata nuk praninin ti jepnin lektë sipas marëveshjes ose lirimin e tokës. Nisur nga këto kërcënime deri në shfarosje me bomba dhe tritol, pjesa më e madhe e drejtuesve dhe menaxherëve të fabrikës kish-

in marë podigardë me qëllim sigurimin me jetës së tyre por dhe familjes. I vetmi që nuk ishte paisur me kushte sigurie ishte 43 vjeçari Anwar Rizik, i cili edhe pse ishte një ndër personat që ishte në listën e zezë të banorëve të kësaj zone, lëvizte i lirë dhe pa pasuar asnjë masë sigurie. Ky vendim me sa duket i ka kushtuar shtrënjtë 43 vjeçarit palestinez, pasi ditën e mërkurë teksa ishte duke hapur derën e jashtme të shtëpisë për të shkuar në

istrimin në dosje të këtyre pamjeve filmike që tregojnë protestat e banorëve para fabrikës, vjen fill pas informacioneve se vetë banorët kanë kërcënuar me vdekje drejtuesit e fabrikës, përfshirë këtu dhe 43 vjeçarin e ndjerë Anwar Rizik. "Ne do i transkriptojmë këto video dhe nëse eidentohen persona që hedhin akuza kërcënuese atëherë do urdhërojmë shoqërimin e menjëhershëm të tyre me qëllim marjen në pyetje. Tani hetimi është në fazën fillestare dhe se ende jemi shumë larg për të arrestuar njeri, për shkak të mungesës së provave materiale, pasi mënyra e ekzekutimit ka qënë tepër e sofistikuar"- thanë burimet pranë prokurorisë së Tiranës. **FILMIMET E AMBASADËS**

Dy kamera që janë instaluar në murin e Ambasadës Amerikane nuk kanë aritur të kapin asnjë person të dyshimtë. Për specialistët e hetimit ato janë konsideruar si të pastra dhe që nuk sjellin asnjë ndihmesë për hetimin.

**Mungesën e sigurisë e kanë studjuar mirë dhe autorët e krimin, të cilët kanë zgjedhur ta eliminojnë fizikisht**

fabrikën e Fushë-Krujës, ai është hedhur në erë nga granatë artizanale që ishte vendosur në derën e shtëpisë. **SEKUESTRO PAMJEVE FILMIKE**

Lidhur me këtë ngjarje, policia e Tiranës dhe prokuroria kanë sekuestruar disa pamje filmike të televizioneve ku shfaqen, banorët të tre fshatrave teksa protestojnë para fabrikës. Vendimi për admin-

**CEREMONIA**

**Meshë për të ndjerin Anwar Rizik**



**N**jë meshë kishtarë është krijuar në Tiranë për nder të shpirtit të Anwar Rizik. Mesha ka filluar në orën 17:00 në Kishën Autoqefale Ortodokse që ndodhet në rrugën e Kavajës. Rreth 500 persona, miq, shokë dhe anëtarë të familjes morën pjesë në këtë meshë, duke u lutur për shpirtin e 43 vjeçarit të vranë në derën e shtëpisë. Dy priftërinj kanë kënduar lutje të shumta, që shpirti i Anwar Rizik të shkojë në parajsë. Mes të pranishmëve ishte dhe vëllai i viktimitë Rami Rizik si dhe drejtues të lartë të fabrikës së çimentos. Pas përfundimit të meshës, njerëzit e pranishëm janë larguar mes lotësh, ndërkohë që bashkëshortja e viktimitë Elda, si dhe vëllai i tij kanë qëndruar duke marë me radhë ngushëllimet e njerëzve të pranishëm.

**400 gramë tritol**

**Akuza: Vrasja me granatë artizanale**

**TIRANE**

**P**rokuroria e Tiranës ka hedhur dritë dhe mbi mekanizmin e lëndës plasëse, ku pas administrimit të të gjitha provave në vendgjatje organit i akuzës ka kontaktuar se lënda shpërthyes ishte një granatë artizanale. Sipas hetuesve të kësaj ngjarje, një kapsoll granate i shoqëruar edhe me siguresën përkatëse ishte futur brenda një qesëje të mbushur me një sasi prej 400 gramë tritol. Në dinamikën që ka ndërtuar prokuroria thuhet se siguresa e grantaës artizanale ishte lidhur me tel me kanatën hapëse të derës, ndërkohë që lënda shpërthyes ishte vendosur në hekurudat e derës. Menjëherë pas hapjes së



derës, është aktivizuar lënda shpërthyes duke e hedhur në erë 43 vjeçarin Anwar Rizik. Aktualisht trupi i këtij të fundit është vendosur në një nga frigoriferët e Institutit të Mjekësisë-Ligjore, pasi vetë familjarët kanë preferuar që ta sillnin trupin në ambientet e shtëpisë. Pritet që ditën e nesërme trupi të tërhiqet nga familjarët dhe më pas të transportohet me avion në drejtim të Palestinës. Ambasada e këtij shteti është duke kryer të gjitha veprimet e dokumentacionit me qëllim marjen sa më parë të lejes nga autoritetet shqiptare, me qëllim nxjerjen e trupit jashtë kufinjve të territorit shqiptar. Nga shteti i Katarit ka mbëritur vëllai i viktimitë, cili nën shoqërimin edhe

me dy kushërinjtë e tij do të shoqërojnë trupin. Ndërkohë që mësohet se në drejtim të Palestinës do të udhëtojë dhe bashkëshortja e viktimitë, Elda, e cila kishte disa vite martesë me 43 vjeçarin Anwar Rizik. Pas ngjarjes së rëndë, drejtues të lartë të fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë si dhe të afërm të viktimitë kanë shkuar me shpejtësi në vendgjatje. Drejtori i fabrikës së çimentos Charl Bouri pas mësimit të lajmit për vrasjen e bashkëpunortit të tij, zv/drejtorit Enëar Rizik ka mbëritur në vendgjatje. Ai ka marë takime me specialistët policisë si dhe familjarët e të ndjerit. Pas qëndrimit për më shumë se 30 minuta, Charl Bauri është larguar për të dhënë deklarime në polici.



## Nuk ka anestezi Ushtaraku pezullon operacionet

Pavloni është njëri ndër anestetikët më të përdorur në vendin tonë, por që në spitalin Ushtarak po shkon drejt mbarimit. Që do të thotë se pa të nuk mund të bëhet asnjë ndërhyrje kirurgjikale. Në mbledhjen e mëngjesit gjatë ditës së djeshme, shefave të të gjithë shërbimeve në këtë spital u është komunikuar të mos bëjnë asnjë lloj ndërhyrje të planifikuar pasi pavloni ishte në sasi fare

të vogla dhe do ta ruanin vetëm për rastet shumë emergjente. Ndërkohë që vetëm pas një orë, në orën 09:00 kanë dalë një urdhër i dytë dhe mjekët janë njoftuar që edhe gjatë ditës së djeshme mund t'i bëjnë operacionet e planifikuara, por jo më në ditët në vazhdim, pasi sasia e pakët e anestetikut që ndodhet në magazinat e spitalit Ushtarak, që pret traumat nga i gjithë vendi është shumë e pakët. Ata,

sipas porosisë së drejtorisë së këtij spitali, do të ruhen për rastet emergjente, duke qenë se Ushtaraku është i vetmi spital ku dërgohen të gjitha rastet e aksidenteve të çdo lloji natyre. Vetë drejtorja e këtij spitali shpjegon se është e vërtetë që ka sasi të kufizuara për momentin, pasi pritet që shumë shpejt të përfundojë tenderi. Por ata garantojnë se për çdo rast urgjent nevojat janë të mbuluara.

**Lajmi**  
Në vendin tonë, plot 100 mijë familje, klasifikohen si të varfëra, pasi nuk arrijnë të sigurojnë as minimumin jetik. Në një studim të detajuar të UNICEF për efektet që shkakton ky nivel i ulët i të ardhurave në cilësinë e jetës së fëmijëve që ata kanë, janë dramatike. Pjesa më e madhe e tyre janë jo vetëm të paarsimuar, por nuk arrijnë të ngopin as barkun me bukë.

**TIRANE**  
ESMERALDA KETA

Studimi është prezantuar dje nga Detlef Palm, përfaqësues i UNICEF në Shqipëri dhe ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili. Studiimi i cili ka monitoruar nga afër situatën në 100 mijë familje, të cilat konsiderohen të varfra në vendin tonë, pasi nuk arrijnë të sigurojnë minimumin jetik, nxjerr një realitet dramatik të këtyre familjeve, por mbi të gjitha të fëmijëve që jetojnë në këto familje. Sipas sondazhit të Unicef, 23% e fëmijëve nën moshën 18 vjeç jetojnë në varfëri absolute me të ardhura mujore jo më shumë se 4800 lekë për frymë, ndërsa 10% e fëmijëve jetojnë nën nivelin e varfërisë ekstreme. Ndërkohë që po sipas këtij studimi 57 për qind e fëmijëve të këtyre familjeve nuk mund të plotësojnë asnjë nga pesë nevojat e konsideruara themelore midis të cilave edhe ushqimi dhe arsimimi apo shëndeti. Varfëria sipas raportit reflektohet dhe në arsimimin dhe shëndetin e fëmijëve të kësaj shtrese, pasi 77 për qind e fëmijëve nuk frekuentojnë arsimin e mesëm. Ndërsa afro 30 për qind e fëmijëve, që vuajnë të paktën nga një sëmundje kronike vijnë nga familje, që jetojnë nën varfërinë ekstreme. Por studimi ka nxjerrë në pah edhe dëshmtimin e skemës së ndihmës ekonomike, pasi në të përfshihen pa të drejtë 59 për qind dhe përjashtohen 47 për qind që kanë nevojë. Vetëm 25 për qind e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë ekstreme marrin ndihmë ekonomike. Në raport thuhet se 50 për qind e fëmijëve që vuajnë nga sëmundjet kronike, nuk për-

## Raporti: Asistencën e përfitojnë padrejtësisht 59% e familjeve

# 100 mijë familje në varfëri ekstreme

## Unicef: 57% e fëmijëve s'ngopen as me bukë



fitojnë rregullisht konsultime mjekësore dhe 65% e fëmijëve, që nuk e frekuentojnë shkollën rregullisht, i përkasin familjeve me të ardhura të ulëta. **NISMAT LIGJORE** Ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili, i cili ka qenë i pranishëm gjatë prezantimit të rezultateve të këtij raporti ka deklaruar se programi që po aplikohet për rrugët e reja të ushqyerjes për gratë dhe fëmijët, pritet të zbusë sëmundshmërinë. "Stimulimi i ushqyerjes me gjë në mënyrë të veçantë për fëmijët, fillimi në kohë i ushqyerjes

shtesë për ta dhe njëkohësisht ndërhyrja në përmirësimin e strukturës ushqimore të fëmijëve, kanë demonstruar, është një e dhënë e cila thotë që për çdo 1 dollar të investuar janë 4 dollarë të fituar. Dhe na ka dëmtuar shumë fragmentimi, pra secili ka punuar në punët e veta" - ka deklaruar ministri Vasili. Por, për përfaqësuesin e Unicef në vendin tonë zgjidhja duhet parë, jo vetëm të rishikimi i skemës së ndihmës ekonomike, por edhe tek gjëja e vendeve të punës për këtë kategori, pasi paratë e ndihmës ekonomike janë të pam-

**100 MIJË FAMILJE JETOJNË NË VARFËRI NË VENDIN TONË**

- 23% e fëmijëve jetojnë në varfëri absolute
- 4800 lekë për frymë janë të ardhurat e tyre mujore
- 10% jetojnë nën nivelin e varfërisë ekstreme
- 25% e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë ekstreme marrin ndihmë ekonomike
- 59% e familjeve që bëjnë pjesë në skemë janë përfshirë pa të drejtë
- 47% e familjeve plotësojnë kushtet për të marrë ndihmë, por s'janë përfshirë në skemë
- 57% e fëmijëve që jetojnë në familje që marrin ndihmë ekonomike se ngopin asnjëherë barkun me bukë dhe janë të paarsimuar
- 77% e fëmijëve nuk frekuentojnë arsimin e mesëm
- 65% e fëmijëve, që nuk e frekuentojnë shkollën rregullisht, u përkasin familjeve me të ardhura të ulëta
- 50% e fëmijëve që vuajnë nga sëmundjet kronike, nuk përfitojnë asnjë ndihmë mjekësore
- 30% e fëmijëve, që vuajnë të paktën nga një sëmundje kronike vijnë nga familje, që jetojnë nën varfërinë ekstreme

jaftueshme. "Në Shqipëri duhet të zbutet niveli i varfërisë. Fëmijët e familjeve që jetojnë nën ndihmë ekonomike keq ushqehen dhe për pasojë rritet niveli i sëmundjeve. Ata gjithashtu nuk janë në gjendje të ndjekin arsimin. Duhet të mendoni të hapni vende pune pasi ndihma ekonomike në çdo vend të botës nuk plotëson kurrë nevojat e familjeve të varfra", - u shpreh

Detlef Palm, përfaqësues i UNICEF. Sipas tij, reduktimi i varfërisë duhet të nisë me fëmijët. "Ndihma ekonomike që jepet sot për familjet e varfra nuk i ndryshon aspak kushtet ku rriten fëmijët e këtyre familjeve. Për çdo një dollarë që ju nuk investoni sot, humbisni 100 milionë dollarë në vit, pasi ka fëmijë të keq ushqyer", - sugjeron Detlef Palm.

### LAJME SHKURT

**Delegacion nga Katar, për projektin e bulevardit**  
Një delegacion nga Katar ka mbërritur në Tiranë për të bërë vlerësimin e projektit strategjik të zgjerimit të bulevardit kryesor, por edhe të disa projekteve të tjera. Kryetari i Bashkisë së Tiranës Lulzim Basha e informoi delegacionin e Katarit, mbi konkursin e zhvilluar për këtë projekt ku morën pjesë 7 ndër 20 studiot më të mira të arkitekturës në botë. Zoti Basha bëri të ditur se vlerësimi për projektet u bë nga arkitektë dhe urbanistë të njohur në mbarë botën.

**Task-forcë për të kontrolluar infermierët**  
Për të verifikuar denoncimet e qytetarëve një task-forcë e posaçme me specialistë nga Autoriteti Rajonal Shëndetësor dhe "Urdhri i Infermierit" po inspekton punën e infermierëve në të gjitha qendrat shëndetësore. Pas konstatimit se shumë ankesa kanë qenë të drejta janë marrë masa administrative. Kanë qenë rreth 100 ankesa të qytetarëve se shumë infermierë nuk i gjejnë në vendin e punës, personeli i mesëm shëndetësor është nën survejimin e "Urdhrit të Infermierit" dhe Autoritetit Rajonal Shëndetësor që kanë filluar kontrollin pas të cilave kanë marrë masa për një sërë shkeljesh të verifikuara. Përgjegjësia për çdo parregullsi tashmë do të bjerë edhe mbi kryeinfermierin, i cili duhet të mbikqyrë situatën dhe shkeljet t'i raportojë në drejtori.

**Mësuesit, shtesë page kur punojnë larg**  
Mësuesit do të kenë tashmë shtesë page për punën e tyre në zonat rurale. Sipas vendimit të dy ditëve më parë të qeverisë, pagesa do të bëhet sipas kilometrave. Kështu, për 10-20 km përfitojnë 1 mijë lekë në muaj, mbi 20 km 1800 lekë në muaj dhe kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre përfitojnë 5200 lekë në muaj. Sipas vendimit të qeverisë edhe transporti i nxënësve që arsimin bazë e kanë larg vendbanimit do të përballohet nga fondi i Ministrisë së Arsimit.

## Parada gay

# Asnjë deputet nuk e konfirmon

**TIRANE**  
Duket se edhe deputetët e kuvendit shqiptar i druhën pjesëmarrjes në festivalin e diversitetit që do të organizohet me datë 17 maj, i përfolur më së shumti në media si "parada gay". Sipas organizatorëve të këtij eventi, që do të organizohet për herë të parë në vendin tonë dhe ka për qëllim të shpallë flamurin e diversitetit, tashmë ftesat u janë dërguar të gjithë deputetëve që bëjnë pjesë në komisionin e ligjeve, në komisionin e integritimit dhe në atë të Cështjeve Sociale. "Në fakt ftesat janë shpërndarë këto ditë dhe deri më tani asnjëri prej këtyre deputetëve nuk ka konfirmuar pjesëmarrjen. Megjithatë është



ende shpejt për këtë gjë. Ftesat ne do ta dërgojmë edhe krerëve të disa prej institucioneve më të rëndësishme në vend", -

na sqarojnë organizatorët e këtij eventi që është "Ambasada Pink". Ndërkohë që ata reagojnë qetësisht dhe pa emocione kundrejt batutave që përfshijnë dy ditë më parë anëtarët e komisionit të integritimit kur panë ftesat për të marrë pjesë në festivalin e diversitetit. "Po kjo është e bukurra e kësaj nismës sonë. Dashje pa dashje përfshihen të gjithë. Pastaj jo nuk është hera e parë që ndodh. Batuta të tilla mund të dëgjosh çdo ditë dhe kudo në Shqipërinë tonë. Synimi ynë është të dalë me sukses aktivitetet që ne do të nim që në mëngjesin e 17 majit", - na thonë përfaqësuesit e "Ambasadës Pink" që mbron të drejtat e komunitetit të gay-ve, lesbikeve, trans dhe biseksuale të njohura ndryshe si komuniteti LGBT.

## CEZ Group, ulen fitimet 16% nga humbjet në Shqipëri

Arsya kryesore pse grupi çek CEZ ka dalë me fitime 16 për qind më të ulta, pas taksave, në tre muajt e parë të këtij viti, është vendimi i pafavorshëm, i marrë nga Enti Rregullator i Energjisë elektrike në Shqipëri. Kjo vihet në dukje në raportin tremujor të kompanisë, që është prezantuar dje në Pragë. Sipas raportit, ERE ka vendosur që të rritë tarifën e

shitjes për energjinë e prodhuar nga Korporata Elektroenergetike Shqiptare me 91 për qind, pa lejuar që operatori i shpërndarjes ta kalojë këtë rritje kostojve te konsumatori fundor. Kjo, së bashku me rritjen e çmimit të energjisë së importuar për të mbuluar humbjet në rrjet, ka sjellë një rezultat negativ në të ardhurat, vihej në dukje në materialin e kompanisë.

Kompania CEZ Shpërndarje, degë e grupit CEZ, ka logaritur se, si pasojë e mospranimit nga institucionet e shtetit shqiptar të kërkesës së saj për rritje të tarifës për klientët fundorë, ajo do të ketë më shumë se gjysëm miliardë dollarë humbje në tre vjet. Për periudhën 2012-2014, ERE ka bllokuar lëvizjen e tarifave, vetëm për CEZ-in

Sipas ekspertëve, pronari shtet i shtet vetvetes prona, Kodi Civil s'e parashikon

# HEC Lanabregas, u shkel ligji

Paralelizëm midis shitjes së Hotel Dajtit Bankës së Shqipërisë dhe hidrocentralit pranë Tiranës, çmime të fryra arbitrarisht për të shmangur rritjen e borxhit të madh publik

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Një ditë pas shitjes së hidrocentralit të Lanabregasit për 15 milionë dollarë, ekspertët të financave dhe të energjetikës kanë hedhur hijen e dyshimit lidhur me ligjshmërinë e këtij transaksioni, të kryer, sipas tyre, në kushtet kur qeveria kërkon me çdo kusht të mbushë arkën e zbratur. "Legjislacioni përsa i përket mënyrës së trajtimit të pronës shtetërore, të shitjes së saj, të

**Lajmi**  
Kalimi i pronës së HEC-it të Lanabregasit të ndërmarrja e ujësjellësit, kundrejt pagesës së 15 milionë dollarëve, shihet nga ekspertët si shkelje ligjore, e ngjashme me atë, të bërë në rastin e blerjes së Hotel Dajtit për 30 milionë euro nga Banka qendrore

privatizimit të saj, apo të transferimit, është i përcaktuar. Aq më tepër kur bëhet fjalë për kalim pronësisë midis dy subjekteve që kanë të njëjtin pronar, që është shteti, e nuk e parashikon as Kodi Civil si formë transaksioni nëpërmjet

shitblerjes, kundrejt një çmimi të caktuar", tha ish-ministri i Financave Anastas Angjeli për Top Channel.

"Ky është një moderacion i mirëfillt i injektimit të parave në buxhetin e shtetit. Është njësoj si operacioni i



shitjes së Hotel Dajtit 30 milionë euro dhe, ja ku e keni, mbas tre vitesh, nuk është bërë asgjë, vetëm ka ngrulur

një varrezë në mes të Tiranës. Pse? Sepse qeveria kishte nevojë për para dhe ky është borxhi i fshehtë që qeveria nuk e merr dot, por detyron ndërmarrje të saj të shkojnë ta marrin te bankat private, me qëllim që, në dukje, të ruajnë nivelin prej 60 për qind ndaj PBB-së, por në fakt ka kaluar megjithë këto borxhe mbi 100 për qind", deklaroi, nga ana e vet, në Kuvend deputeti Erjon Braçe.

Kurse Pajtim Bello, ish-ministër i Energjetikës, deklaroi se ky është një transaksion me kosto të madhe për

qytetarët. "Momentalisht, buxheti i shtetit është një aktor që përfiton 15 milionë euro, ndërkohë, për këtë para, qytetarët e Tiranës do të paguanë kredinë, principlin plus interesat, që do të shkojnë, megjithë administrimin e kredisë, në rreth 20 milionë euro", tha ai. Sipas Bellos, ekspert i shpërndarjes së energjisë, çmimi i shitjes është abuziv, pasi një hidrocentral me fuqi sa Lanabregasi mund të ndërtohet me gjysmën e çmimit të kur e blen Ujësjellësi, duke u kursyer qytetarëve 7.5 deri në 8 milionë euro.

## Energjia elektrike

# Të dhënat e klientëve, CEZ përditëson arkivin

■ ■ ■ TIRANE

Në përpjekje për të modernizuar shërbimin ndaj klientëve, kompania e shpërndarjes së energjisë elektrike në vend ka ndërmarrë një fushatë, që synon të vendosë mbi baza të sakta informative të dhënat e të gjithë personave, me të cilët ka lidhur kontrata. "Master Data Cleaning" ose "pastrimi i të dhënave tëlbësore" është titulluar një nga projektet e rëndësishëm të kompanisë CEZ Shpërndarje. Synimi i këtij projekti është rifreskimi dhe përditësimi i të dhënave të klientëve: familjarë, individë, biznese, buxhetorë dhe jo-buxhetorë, për të shmangur dhe korrigjuar gabimet në të dhënat kryesore, si psh. gabime në emër, mbiemër, adresë, numra kontakti dhe një pjesë të të dhënave teknike të sistemit të matjes.

Që nga muaji korrik 2011, në të gjitha Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit, klientët e CEZ Shpërndarje mund të plotësojnë formularët e posaçëm, të cilët shërbejnë për të korrigjuar apo përditësuar të dhënat e tyre. Ky projekt është implementuar në disa shkallë. Në fillim u promovua si një projekt provizor, ku u rrifreskuan të dhënat demografike. Për promovimin e tij, u organizua edhe një lotari, e cila nxorri si fitues të çmimit prej 2.500 eurosh dy klientë, që u përzgjedhën në mënyrë rastësore nëpërmjet shorteut të organizuar.

Tashmë projekti ka hyrë në një fazë të re implementimi, nga ku po grumbullohen dhe saktësohen, jo



## Projekti

Për ta bërë sa më të lehtë punën për klientët, shumë shpejt nga ana e CEZ Shpërndarjes do të lançohet edhe një format on-line, për plotësimin e të dhënave të përditësuar nëpërmjet internetit

movuar risitë, ndryshimet dhe përmirësimet në shërbimin e kompanisë.

Gentiana Hykaj, Drejtore e Zyrës së Projekteve pranë CEZ Shpërndarje, i është përgjigjur si më poshtë interesimit të Shqiptarja.com lidhur me këtë projekt.

**Projekti i "Data Cleaning" erdhi si iniciativë e cilit departament pranë kompanisë suaj dhe cili ishte motivimi?**

Ky është një projekt për divizionin e shitjeve, në bashkëpunim të ngushtë edhe me Kujdesin ndaj Klientit, por dhe me departamente të tjera, si IT, etj. Shtyrsa për këtë motivim është - si gjithmonë - kërkesa jonë për përmirësim të shërbimit që u ofrojmë klientëve tanë. Nëpërmjet këtij projekti, synohet që të përmirësojmë data-bazën tonë të të dhënave të klientëve, në mënyrë që të evitohen në maksimum problemet e shpërndarjes së faturave për shkak të adresave të pasakta; të ndihmojmë në krijimin e një shërbimi gjithmonë e më eficient dhe aktiv nëpërmjet Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit; të ndihmojmë në përmirësimin e përgjithshëm të

shërbimit dhe imazhit të kompanisë.

**Deri më sot, sa është numri i klientëve që kanë qenë subjekt i këtij projekti?**

Deri në këto momente, 42.000 klientë të CEZ Shpërndarje kanë plotësuar formularin e saktësimi të të dhënave, duke kontribuar në krijimin e një data-baze të saktë.

**Besojmë se hasni edhe vështrirësi në realizimin e këtij projekti. Cilat janë disa nga vështrirësitë me të cilat ndesheni në praktikë?**

Po, ka shumë klientë që hezitojnë të plotësojnë formularin e saktësimi të të dhënave, duke menduar se kjo mund të ketë ndonjë kosto financiare për ta. Një pjesë hezitojnë sepse nuk e kuptojnë rëndësinë e këtyre të dhënave dhe ndoshta, nuk janë të informuar se çfare impakti ka saktësia e tyre për një klient. Në fakt, plotësimi i formularit na ndihmon që ne t'ju shërbejmë sa më mirë klientëve tanë.

**Që të dhënat e një X klienti të quhen të sakta, çfarë kritere duhet të përmbushen?**

Emri, mbiemri dhe adresa duhet të jenë të dhëna të plota dhe të sakta. Gjithashtu, duhet edhe një adresë e saktë fizike, ku kompania të mund të dërgojë faturën e energjisë së konsumuar apo edhe materiale informuese. Gjithashtu, është i nevojshëm edhe numri i kartës së identitetit, sepse kjo mundëson dallimin midis dy klientëve të ndryshëm me të njëjtin emër dhe mbiemër.



**VALË UHF**

**NË PREFEKTURAT:**  
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER



**DIGITALB**

**KANALI 50**  
Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

**Mund ta ndiqni A1-Report në këto televizione kablore:**

**NE SHQIPERI**

**Televizioni**  
MRM  
Intel Media  
Inkusat  
TVM Devolli  
Vjosa  
Toshkez  
Bradsat  
Erzeni  
Luna  
Maruxho  
Permeti

**Qyteti**  
Korçë  
Fier  
Pogradec  
Devoll  
Vlore  
Lushnje  
Elbasan  
Shijak  
Kavaje  
Bulqize  
Permet

Iria  
Policani  
Elbasan North & South  
Kombi  
Lushnja  
Prenjas  
Alfa Kabell  
Cakran  
Kucova  
Lapardhaja  
Brado  
Onkumi  
Asparag  
Mati

Berat  
Berat  
Elbasan  
Fier  
Lushnje  
Prenjas  
Tirane  
Fier  
Kucove  
Berat  
Elbasan  
Vlore  
Vlore  
Rrogzohine  
Mat

Kukesi  
Orxhi  
Maqellara  
Multivizion  
Tata Junior  
Dijaka  
M&G  
Ura Vajgurore  
Sarandë Digital  
Pupa  
Roskovec  
HB-CA  
Eri A&A  
Iliria

Kukes  
Fier  
Diber  
Kavaje  
B.Curri  
Lushnje  
Elbasan  
Berat  
Sarande  
Lushnje  
Fier  
Peshkopi  
Ballsh  
Berat

Reci KGM  
S3  
Ju-al  
Mamurras  
Manastiri  
Belshi  
ARD&NET

**NE MAQEDONI**

Multimedia  
Telenet  
Skupi Cable

Lezhe  
Tirane  
Kruje  
Lac  
Fier  
Elbasan  
Fier

Maqedoni  
Maqedoni  
Maqedoni

# Së shpejti...

**TELEVIZIONI  
MË I RI  
INFORMATIV  
NË SHQIPËRI**



**Redaksia & Marketing**

*Rruga:* "Dervish Hima",  
Tire kullat, kulla e dytë, Tiranë  
*mobile:* +355 69 60 60 421  
*marketing:* +355 69 60 60 419

Studiot e prodhimit A1  
*Rruga:* "Aleksandër Moisiu"  
ish-Kinostudio Shqipëria Sot

# A1 REPORT!

origjina e lajmit...

## Lajmi në High Definition

Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat profesionale të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike

Himara

► Faqe 14

## Miresevini në parajsën e bregdetit jonian

Hapet sezoni turistik.  
Jorgo Goro: Himara plot aktivitet dhe argëtim



Firence

## Të prekësh Rilindjen në 48 orë

Në Firence mund të vizitosh disa nga veprat më të famshme të botës si "Pallazo Vecchio, Academia delle Arti ku gjendet skulptura e famshme e Davidit të Mikelanxhelos. Galeria e famshme "Offizi" ku gjenden veprat e mëdha të rilindjes. Pastaj vijnë Kisha Santa Maria del Fiore e katërta më e madhe në Europë. Kur hyn në Firence mezi pret



të shohësh këtë katedrale me kupolën e saj. Një nga vendet më interesante dhe tërheqëse është "Ponte Vecchio" një nga urat mesjetare. Gjatë gjithë ditës është vendi i preferuar i turistëve me dyqanet e shumta që janë vendosur aty. Firence është një qytet-galeri. Por nëse do të vizitoni....

► Faqe 15

Nr: 14 E premte, 11 maj 2012

E-mail: fundjava@shqiptarja.com

# Fundjava

Suplementi i së premtes të SHQIPTARJA.com



KRISTAQ SKRAMI/ INTERVISTE E DYZUAR MES DUKES DHE DREJTORIT PARA NISJES PER NE LONDER

## NJE DREJTOR NEN PETKUN E DUKES

Pas një mungese të gjatë në skenë, drejtori i Teatrit Kombëtar, vesh petkun e dukës tek "Henri VI"

■ ■ ■ TIRANË

ROVENA RROZHANI

Gjashtë vite në zyrën e drejtorit nuk e kanë dembelosur aktorin Kristaq Skrami. Koha e shfaqjeve që dukej sikur ishte ndalur në skenën e Vlorës, u rikthye. Prej fundjavës së kaluar, drejtori i Teatrit Kombëtar, dha tri shfaqjet e tij të para si Duka Gloucester. Një rikthim i fortë në një karakter të fuqishëm, dhe për më tepër që i kërkon sfidën jo vetëm në skenën kombëtare, por edhe atë angleze. Por edhe pse Duka ia doli të drejtonte mbretërinë angleze për dhjetë vjet, nuk ia doli që ta shmangë drejtorin. Gjatë provave gjenerale, aty ku diçka ngecete, Duka dilte nga prapaska dhe vëzhgon-te me syrin e drejtorit se çfarë nuk po shkonte. Një udhëtim i dyfishtë,



aspak i lehtë për Kristaq Skramin, por që siç thotë ai vetë, arriti ta çojë deri në fund.

**Si ndodhi, që ju u gjendët brenda skenës, pas disa vitesh jashtë saj?**

Më vjen mirë që e fillojmë inter-

vistën me këtë pyetje dhe duhet të them që në momentin që vendosa të isha pjesë e "Henri VI" padyshim që kanë qenë shumë arsye. Të paktën një vit më parë, unë kam qenë në Londër bashkë me regjisorin Adonis Filipi, ku morëm përgjigjen përfundimtare që trupa e Teatrit Ko-

mbëtar do të ishte pjesmarrëse në Festivalin Botëror të Shekspir-it. Natyrisht që kjo ishte një ngjarje shumë e madhe për mua jo vetëm si drejtues, por dhe si aktor. Më ngacmoi menjëherë. Arsyeja e thjeshtë. Unë ato ditë vizitova edhe Globus Teater dhe të luash aty, në

shtëpinë e Shekspir-it, është një mundësi që jo të gjithë aktorët e kanë. Është një skenë dhe një auditor madhështor, i papërsëritshëm. Duke i shtuar kësaj edhe shumë arsye të tjera si mungesa disavjecare larg skenës vendosa të marr pjesë në "Henri VI"...

► Vijnë në faqen 19

Kuzhina

► Faqe 18



### Finoku, tre mënyra të shpejta gatimi



### Aliçka rrëfen Valsin e lumturisë

### Eno Koço: Sonte klasikët më të mirë



► Faqe 20

► Faqe 17

## Dëshironi të udhëtoni?

**HAPET** sezoni turistik 2012 në Himarë. Festa fton turistët në perlën e bregdetit jonian

# HIMARA

## Mirësevini në parajsë!

### Fundjavë e magjishme në bregdet

Një fundjavë e magjishme?! Nuk është një thirrje rekreative, por një ftesë e prekshme për të përjetuar dy ditë plot festime e blatime për sezonin e ri veror. Festa ju drejton për nga Himara, e cila në 12 dhe 13 maj pret turistë nga e gjithë Shqipëria. Dhe për ta shndërruar në një festë të vërtetë, bashkia e Himarës ka hartuar një program të detajuar që do të joshë këdo që kësaj fundjave të mos mendonte për asnjë udhëtim tjetër veç destinacionit jugor.

Dita e shtunë do të ndezë qytetin me një atmosferë këngësh, ku për të festuar do të jenë të pranishëm këngëtarët Elvana Gjata, Flori Mumajesi, Nrg Band, Klandi Haruni dhe Andy Gramm.

Të dielën skena hapet për Vëllezërit Korçarë, ndërsa për fansat e sporteve të ndryshme do të ofrohen zhytje, ngjitje në mal, dhe fluturime me parashutë.

Nuk do të mungojnë animacionet e larmishme dhe në fund, por jo e fundit për nga rëndësia nuk do të mungojë ushqimi tradicional, natyrisht me bazë peshku. Kapakun kësaj ftese të florinjtit ia vë një ofertë të

**Aktiviteti do tu japë mundësinë edhe banorëve që të bashkohen dhe të promovojnë vlerat e qytetit të tyre, me kulturën, traditat, ushqimin tradicional etj**



pazakontë: akomodim falas për të gjithë për datën 12 maj.

Qëllimi i vetëm i të gjithë kësaj është një: Të gjithë qytetarët ta zgjedhin Himarën si vendin ideal për pushimet e tyre të paharrueshme.

Aktiviteti do tu japë mundësinë

edhe banorëve që të bashkohen dhe të promovojnë vlerat e qytetit të tyre, me kulturën, traditat, ushqimin tradicional etj.

Himara është një nga vendet më atraktive për turizmin shqiptar e të huaj. Bashkia e Himarës përfshin

zonat e Dhërmi, Pilur, Kudhës, Qeparo, Vuno, Ilias dhe Palasës, vende këto që spikasin gjatë sezonit veror për fluksin e lartë të turistëve të cilët e kanë si "Perla e Jonit", "Lule e Vilajetit" apo "Shtëpia Jonë e për-bashkët".

Ja çfarë mund të bëni në Himarë

#### Guida Turistike

Për adhuruesit e artit, kulturës dhe historisë së Himarës do të ketë dy guida turistike tokësore. Guida turistike tokësore do të përfshijë vizita në Kalanë e Himarës, dhe të Ali Pashë Tepelenës.

#### Alpinizëm

Të gjithë adhuruesit e turizmit malor të dielën do të kenë mundësi të kryejnë ngjitje të shoqëruar nga disa instruktorë.

#### Kanoe

Një pjesë tjetër argëtimi do të jetë gara me kanoa në detin Jon të Himarës, ku të gjithë pjesëmarrësit mund të jenë shikuesit ose lojtarët.

#### Zhytje

Për të gjithë të apasionuarit dhe kureshtarët e jetës në ujë, një tjetër aktivitet që do të zhvillohet paralelisht me aktivitetet e tjera është pikërisht Diving

#### Parashutë

Hedhje me parashutë nga mali i Llogarasë për ata që e pëlqejnë "treqikun", ku adrenalina kap majat dhe është e paeitueshme.

## Programi

**2012**

Hapja e sezonit veror

**12 Maj , Shtunë.**

Koncert me Muzikë Moderne në Shëtitoren Manolo. Të ftuar këngëtarët Elvana Gjata, Flori Mumajesi, Klajdi Haruni, Andy Gramm, NRG Band. Pjesë e mbrëmjes do të jetë edhe grupi "Street Artist", që do të dhurojnë një Shoë spektakolar që shumë nga pjesëmarrësit nuk e kanë parë ndonjëherë.

Në mbrëmje do të hidhen minibalonat që do të ndriçojnë qiellin. Ato do t'u jepen të gjithë pjesëmarrësve dhe do të lëshohen prej tyre pas përfundimit të Koncertit.

**13 maj e diel**

Rreth orës 09:30 një grup animatorësh do të argëtojnë fëmijët. Në shëtitoren Manolo do të mbahet Fjalimi nga personalitetet më të larta të pushtetit qendror dhe vendor. Pas fjalimit të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të shijojnë ushqime tradicionale të përgatitura nga vendasit dhe restorantet, që do të jenë vendosur në banketin e ushqimeve tek Shëtitorja. Festa do të vazhdojë me Vëllezërit Korçarë, Endri & Stefi Priifti deri në orën 14:30. Pas kësaj të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësi të zgjedhin se si të argëtohen në pjesën tjetër të ditës falë animacionit, guidës Turistike, alpinizmit, garave me kanoe, zhytjeve në det dhe hedhjeve me parashutë.

## Kryetari i bashkisë

# Jorgo Goro: Himara plot aktivitetet dhe argëtim

FERNADA CENKO

Kryetari i bashkisë së Himarës, Jorgo Goro ka sjellë risitë se çfarë do të ofrojë Himara në sesionin turistik. Data 12 dhe 13 është përcaktuar nga bashkia për tu çelur turizmi për këtë sesion. Gjatë një interviste për gazetën "Shqiptarja.com", Zoti Goro nga ka dhënë detaje mbi organizimin e festës. Në pamundësi financiare, Goro ka ftuar bizneset e Himarës dhe Shqipërisë për të pasur një organizim sa më të bukur gjatë sesionit të verës dhe sa më argëtues për rininë shqiptare.

**Zoti Goro, jemi në prag të çeljes së sesionit turistik, çfarë**



**i ofron Himara turistëve në ndryshim nga vitet e tjera?**

Për këtë vit, dhe si viti i parë i mandatit tim, jam munduar të sjell diçka më ndryshe si në organizimin e ceromisë së hapjes së sesionit, por edhe shërbimet që do të ofrohen, për të pasur pushime verore të qeta dhe

argëtuese. Më herët se vitet e tjera, Këshilli Bashkiak ka miratuar masat që do të ndërmerren gjatë sesionit veror. Së pari kemi filluar të pastrojmë plazhet, kemi larguar ndërtime pa leje që janë bërë përgjatë bregdetit, për t'i dhënë mundësi qytetarëve ta shijojnë atë, dhe kjo për tu dhënë turistëve natyrën e pastër, që Himara e përcjell më së miri. Kemi shtuar aktivitetet për turistët dhe këtë vit do të ketë shumë larmishmëri. E veçanta e këtij viti është se në mungesë të fondeve nga qeveria jemi munduar që të ftojme bizneset për të sjellë një ritëm të ndryshëm nga ai i vitit të kaluar. Do të ishte shumë mirë të na kishte mbështetur qeveria, por shpresojmë që vitin tjetër të mbajë premtimet e

dhëna.

**Si e keni organizuar çeljen e turizmit?**

Është vendosur data 12 dhe 13 Maj për të hapur sezonin turistik. Ditën e shtunë do të ketë koncert me Muzikë Moderne në Shëtitoren Manolo. Të ftuar këngëtarët Elvana Gjata, Flori Mumajesi, Klajdi Haruni, Andy Gramm, NRG Band. Pjesë e mbrëmjes do të jetë edhe grupi "Street Artist", që do të dhurojnë një shou spektakolar që shumë nga pjesëmarrësit nuk e kanë parë ndonjëherë. Në mbrëmje do të hidhen minibalonat që do të ndriçojnë qiellin. Ato do t'u jepen të gjithë pjesëmarrësve dhe do të lëshohen prej tyre pas përfundimit të Koncertit.

Ndërsa ditën e dielë, rreth orës 09:30 një grup animatorësh do të argëtojnë fëmijët. Në shëtitoren Manolo do të mbahet Fjalimi nga personalitetet më të larta të pushtetit qendror dhe vendor. Pas fjalimit të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të shijojnë ushqime tradicionale të përgatitura nga vendasit dhe restorantet, që do të jenë vendosur në banketin e ushqimeve tek Shëtitorja. Festa do të vazhdojë me Vëllezërit Korçarë, Endri & Stefi Priifti deri në orën 14:30. Pas kësaj të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësi të zgjedhin se si të argëtohen në pjesën tjetër të ditës falë animacionit, guidës Turistike, alpinizmit, garave me kanoe, zhytjeve në det dhe hedhjeve me parashutë.

## Dëshironi të udhëtoni?

### Maji në Firenze

Përpos muzeve të shumtë në qytet, gjatë majit ka disa aktivitete. Nga 20 maji deri në 3 qershor në Galerinë Arazzi zhvillohet "Epifani e veshjeve të omuara". Ndërsa Panairi i turizmit mbahet nga 18 deri në 20 maj

Në Firenze mund të vizitosh disa nga veprat më të famshme të botës si "Palazzo Vecchio, Accademia delle Arti ku gjendet skulptura e famshme e Davidit të Mikelanxhelos. Galeria e famshme "Offizi" ku gjenden veprat e mëdha të rilindjes. Pastaj vijnë Kisha Santa Maria del Fiore e katërta më e madhe në Europë. Kur hyn në Firenze mezi pret të shohësh këtë katedrale me kupolën e saj. Një nga vendet më interesante dhe tërheqëse është "Ponte Vecchio" një nga urat mesjetare. Gjatë gjithë ditës është vendi i preferuar i turistëve me dyqanet e shumta që janë vendosur aty. Firenze është një qytet-galeri.

Por nëse do të vizitoni Firencen për vetëm dy ditë mund të ndiqni këtë itinerar që do t'ju ndihmojë të shikoni qytetin ndryshe sidomos nëse keni qenë herë të tjera. Jo shumë larg nga stacioni hekurudhor i Santa Maria Novella, kryevepër e arkitekturës racionaliste të fillimit të viteve 900, do shikoni edhe bazilikën që i ka dhënë emrin. Santa Maria Novella është kisha dyqindvjeçare, ka një fasadë elegante prej mermeri të bardhë e të gjelbër të projektuar nga Leon Battista Alberti. Pjesa e brendshme e kishës me stili gotik nuk duhet humbur pasi mund të sodisni afresket e ndryshme dhe kryevepra të artit të rilindjes italiane. Duke ecur në rrugicat e ngushta mund të arrini në rrugën Tornabuoni, një nga rrugët më elegante të qytetit ku duhet edhe Pallati Strozzi një nga godinat më sinjifikuese të rilindjes në Firenze. Pallati ka një oborr madhështor gjithnjë të hapur dhe në të zhvillohen vazhdimisht ekspozita pikturë. Nëse shkon drejt sheshit Duomo dhe e kalon, arrin në rrugën Martelli, e vetëm pask metra më larg shikoni një tjetër godinë të rilindjes, Pallatin Medici Riccardi. I shndërruar në seli të Firences, pallati është edhe një muze më vete me ambiente monumentale dhe Kapelë të shkëlqyer, të mbushur me afreske të Benozzo Bozzoli. Dy vende të lidhura me këtë Pallat janë Kisha San Lorenzo e manastiri i San Marco-s. San Lorenzo ishte kisha e familjes Medici; e projektuar nga Filippo



Në foto: Kupola Santa Maria Del Fiore

# FIRENCE

## Si të prekësh Rilindjen në 48 orë

Ja çfarë nuk duhet lënë pa u vizituar

Brunelleschi dhe është një shembull i pastër i arkitekturës rilindase. Fasada ka mbetur e pambaruar, ndërsa në brendësi ka shumë kryevepra të pikturës.

Rreth kishës gjenden objekte të rëndësishme si Biblioteka Mediceo Laurenziana, Sagrestia Vecchia (Muzeu i Thesarit San Lorenzo), Kapelat Medicee, me Sagrestia Nuova, kryevepër e Mikelanxhelos. E gjithë zona ka një treg plot veshje e aksesore që adhurorhet nga turistët.

Duke u kthyer në Pallatin Medici e duke ndjekur rrugën a Cavour arrin në sheshin San Marco. Përveç muzeut me të njëjtin emër gjendet aty edhe Galeria E Akademisë, një nga muzet më të vizituar në Firenze për shkak se aty gjendet Davidi I famshëm i Mike-

### Festivali i Akullores

Akullorja është pjesë e historisë së Firences. Prej tre vitesh në këtë qytet zhvillohet edhe Festivali i Akullores. Ky festival përfaqëson një udhëtim emocional në botën e ëmbëlsirës së ftohtë. Tema e këtij viti është Akullores, Ushqim, Kulturë. Festivali i Akullores zhvillohet nga datat 23 deri në- 27 maj.

lanxhelos. Megjithatë muzeu ka edhe shumë skulptura të tjera të tij si dhe piktura të shumta që datojnë nga mes shekujve 13 dhe 16. Nëse keni kohë shikoni edhe sheshin Santissima Annunziata të mbushur me godina historike, pranë kishës me të njëjtin emër gjendet i Muzeu arkeologjik, ku janë mbledhur objekte etruske, romake e sidomos egjiptiane.



Bazilika Santa Maria

### Roland Tasho: Tifoz i Firences

Për ne të rinjtë e Tiranës së viteve '75-'80 ishte e zakonshme të ishe tifoz i skuadrave italiane pasi e ndiqnim shumë kampionatin e futbollit të vendit fqinj. Që në 8-vjeçare në fëmijërinë tonë zgjidhni skuadrën tonë të Italisë. Në atë kohë burni i tezes operator Beqir Derhemi shikon në Firenze dhe kur kthehet më sjell fotografinë e një futbollisti të ri që quhej Xh Antonioni që më vonë u bë një futbollist i kombëtares italiane. Ishte ky moment kur unë u bëra tifoz i Fiorentinës, skuadrës së Firences dhe që nga ajo kohë lexoja çdo gjë që kishte të bënte me këtë qytet. Kur shkova për herë të parë në Itali në vitin 1992 nuk mund të rrija pa vizituar vendin tim të preferuar të cilin e kisha ëndërruar prej kohësh, Firencen. Sapo hyra në atë qytet më dukë sikur kisha qenë më parë atje. E njihja qytetin nga leximet dhe fotografitë që kisha parë më parë. Ndiqja rrugët me instiktin e fotografit që këmbët më çonin në vendet më të njohura të Firences. Që atëherë e kam vizituar këtë qytet me dhjetra herë dhe gjithmonë kam dëshirë të shkoj. Në kuadër të projektit me shpirtarët e sukseshëm në Itali, një stacion i rëndësishëm ishte Firenze.



"Davidi" i Mikelanxhelos në Galerinë e Akademisë

**NJË ITINERAR** për të zbuluar një nga qytetet më të njohura italiane, mes artit të rilindjes, historisë dhe një arkitekture mbresëlënëse

### Akomodimi

#### Starhotels M.

#### Luks në gjirin e Rilindjes

Hoteli me pesë yje, i vendosur në Parco delle Cascine Istarhotels Michelangelo është një hotel luksi në gjirin e Rilindjes Italiane duke u shndërruar në një vend ideal për qëndrimin e turistëve Starhotels Michelangelo u ofron klientët të tij bicikleta falas. Restoranti i brendshëm ofron një menu të pasur a la carte. Dhomat fillojnë nga 110 euro

Tel:055 27841

#### San Gallo Palace

#### 10 minuta larg monumenteve

Hoteli disponon 55 dhoma. Ai gjendet në qendër të Firences vetëm 10 minuta në këmbë larg atraksioneve turistike. Hoteli u ofron klientëve të tij një pushim absolut, qetësinë e një kopshti të brendshëm si dhe një snack bar të hapur 24 orë i cili ofron edhe gatime teesant për mëngjes. Dhomat fillojnë nga 87 euro

Tel: 055 463871

#### Hilton Garden Inn

#### Katër yje për 77 euro

Hoteli me katër yje ka 121 dhoma të pajisura me internet, skirvani, shërbim privat, tv e telefon. Në disa prej këtyre dhoma ndalohet duhani.Restoranti ofron kuzhinë toscane, kombëtare dhe ndërkombëtare. Për ata që preferojnë relaksin është lounge bar ose një verandë e hapur. Palestra falas. Dhomat fillojnë nga 77 euro

Tel: 055 42401

#### La Fortezza

#### Transferitë dhe shëtitje ofertë

I vendosur në një vilë të shekullit të 19, hoteli elegant gjendet një kilometër larg siteve të rëndësishme turistike. Ai merr përsipër transferitën e klientëve të tij nga aeroporti dhe organizimin e shëtitjeve të ndryshme rreth zonës. Kuzhina është tipike e zonës. Dhomat fillojnë nga 94 euro.

Tel:055 4639101

## Dëshiron të shkosh në kinema?

**NGA NJË VJEDHJE** në zemër të Manhattanit, tek një histori dramatike në zemër të Ballkanit

# Fillojnë në kinema projeksionet e trillerit me protagonist aktorin Sam Worthington “Man on...” beteja për diamantet

Regjisori Asger Leth arrin të ruajë tensionin dhe ankthin deri në fund të filmit



Në zemër të Manhattanit, duke ngritur sytë drejt qiellit dikush sheh Nick Cassidy, tek ndodhet në parvazin e një hoteli në katin e 23-të të tij. Burri kërcënon se do të hidhet dhe menjëherë policia vihet në lëvizje. Rruga mbyllet për trafikun, mbërrijnë televizionet për të xhiruar dhe për të dhënë lajmin e fundit, turma qëndon e palëvizur ndërsa e kaluara e Nick fillon të zbardhet në media. Edhe ai ka qenë një polic. Dy vjet më parë përfundoi në burg për një krim që nuk e kishte kryer. Ai është gati që të pastrojë imazhin e tij dhe në rastin më të parë, arratiset nga burgu dhe shpik një plan të dëshpëruar që e con në par-

vazin e një hoteli të lartë. Është atje për të hedhur kartmonedha për njerëzit duke u shndërruar kështu në një “hero” popullor, të dashur nga turma që deri para pak minutash priste të shikonte “spektaklin” e hedhjes. Por ndërsa policia vazhdon hetimet dhe përpjekjet vetëm një psikologe beson tek pafajësia e Nick. Ajo bëhet negociatore e policisë, që ta shpëtojë. Por nuk e di se në të njëjtin kohë vëllai i Nick është vetëm një hap larg kryerjes më të madhe të vjedhjes së diamanteve në të gjithë historinë... Kjo është historia e trillerit “Man on a ledge” që fillon projeksionet prej datës 9 maj në kinema. Filmi i regjisorit Asger Leth, ka për

protagonistë aktorë të njohur si Sam Worthington, Elizabeth Banks, Jamie Bell apo Ed Harris. “Man on a ledge” arrin me efikasitet që të çudisë spektatorin skenë pas skene, sidomos në pjesën e parë të filmit kur askush nuk e di se çfarë e ka shtyrë Nick Cassidy (Sam Worthington) në parvazin e katit të 23-të të një pallati. Nuk dihet çfarë loje po luan, çfarë ka në mendje, përse ka kërkuar një negociatore në mënyrë të vçantë dhe për çfarë ka shkuar më parë në burg. Por kur i gjithë ky mister zbardhet, kureshtja në film sërish qëndron, kjo sepse regjisori Asger Leth arrin të ruajë tension dhe ankthin, duke luajtur gjithnjë në rrafshin narrativ.

### PROGRAMET E KINEMASE

#### NE FUNDJAVE



#### Filmat në sallë

“Man on a ledge”  
(Në të gjitha oraret)

#### Orari dhe Çmimet

**Filmi 2D**  
 ora 10:30 – 300 lekë  
 ora 13:00 – 300 lekë  
 ora 15:30 – 500 lekë  
 ora 18:00 – 500 lekë  
 ora 20:30 – 500 lekë  
 ora 23:00 – 500 lekë

**Filmi 3D**  
 ora 10:30 – 500 lekë  
 ora 13:00 – 500 lekë  
 ora 15:30 – 700 lekë  
 ora 18:00 – 700 lekë  
 ora 20:30 – 700 lekë  
 ora 23:00 – 700 lekë

#### NE FUNDJAVE



#### Filmat në sala

“The Lorax”  
(Ora 10:30 dhe në 12:30)

“In the Land of Blood...”  
(Ora 15:30 dhe në 17:30)

#### Orari dhe Çmimet

ora 13:00 – 500 lekë  
**Qendra Kristal**  
 ora 18:00 – 500 lekë  
**Qendra Kristal**  
 ora 12:30 – 500 lekë AGIMI  
 ora 17:30 – 500 lekë AGIMI  
 ora 20:00 – 500 lekë AGIMI  
 ora 22:00 – 500 lekë AGIMI

## “Toka” e Jolie në Tiranë

Filmi ku Angelina Jolie është regjisore, “In the Land of Blood and Honey” po shfaqet edhe për publikun e Tiranës. Filmi tregon historinë e Danieli (interpretuar nga Goran Kostic) dhe Ajla (interpretuar nga Zana Marjanovic), dy njerëz që vinin nga dy vende me konflikt të forta etnike midis tyre.

Danieli, një ushtar që luftonte për Serbinë dhe Ajla, një boshnjake, e mbajtur peng në kampin që ai mbikqyrte, ishin njohur dhe dashuruar me njëri-tjetrin përpara luftës. Tashme asgjë nuk është si më parë: marrëdhënia e tyre zbehet dhe



### SKEDA E FILMIT

**Titulli:** “In the Land of Blood and Honey”

**Regjia:** Angelina Jolie

**Skenari:** Angelina Jolie

**Aktorë:** Zana Marjanovic, Goran Kostic, Vanesa Glodjo, Rade Serbedzija

**Gjinia:** Luftë, Drame, Romance

**Kohëzgjatja:** 2 orë

ndjenjat mes tyre bëhen të paqarta.

“In the Land of Blood and Honey” portretizon barrën e rëndë emocionale, morale dhe fizike që ushtron lufta si në individin ashtu dhe në shoqëri në tërësi dhe pasojat që vijnë nga mungesa e vullnetit politik për të ndërhyrë

në shoqëri dhe plagosur nga konfliktet. Për këtë film ka pasur disa protesta nga Bosnja, të cilat janë fashitur menjëherë pas replikës së Jolie. Aktorja këtë herë si regjisore ia ka dalë të jetë ndër kandidatët për filmin më të mirë të huaj në Golden Globe 2012, ndonëse nuk fitoi çmimin.

## “The Lorax”, magji në 3D

Dr. Seuss’ the Lorax” shfaqet edhe këtë fundjavë në kinema. Fëmijë dhe të rritur mund të shohin një nga krijimet më të fundit hollivudiane në gjininë e animacionit dhe për më tepër në 3D. Filmi tregon historinë klasike të Dr. Seuss që tregon për fuqinë e shpresës në jetë. Kjo aventurë e animuar tregon historinë e një djaloshi 12-vjeçar që është në kërkim të

### SKEDA E FILMIT

**Titulli:** “Dr. Seuss’ the Lorax”

**Regjia:** Chris Renaud, Kyle Balda

**Skenari:** Cinco Paul, Ken Daurio

**Aktorë:** Danny DeVito, Zac Efron, Ed Helms, Taylor Swift

**Gjinia:** Animacion

**Kohëzgjatja:** 94 minuta

dickaje që do ta bëjë atë të fitojë zemrën e vajzës së ëndrrave të tij. Për ta gjetur atë

ai fillimisht duhet të zbulojë historinë e Lorax, një krijese simpatike që lufton për të

mbrojtur botën e tij. Personazhet kanë zërat e aktorëve të njohur si : Danny DeVito, Zac Efron, Ed Helms apo Taylor Swift. “The lorax” është shfaqur premierë botërore më 2 mars dhe prej atëherë është shtrirë thuasë në të gjitha sallat e kinemave në botë. Vetëm në disa shtete europiane si Francë, angli, Gjermania apo Irlandë filmi dot e shfaqet në korrik të këtij viti.



## Dëshiron të ndjekësh një spektakël?

**NJË PJESË** e panjohur e Brahms, uvertura nga opera "Fidelio" dhe e vetmja pjesë e Mozartit për klarinetë

# Koço: Ju sjellim ajkën e muzikës klasike

Dirigjenti tregon detajet e koncertit të sotëm

NGA ROVENA RROZHANI

Te kompozitorë të mëdhenj Mozart, Beethoven, Brahms janë pjesë e koncertit të radhës së Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar. Të premtën në orën 19.00 në sallën e Universitetit të Arteve muzikantët shqiptarë mes të cilëve edhe dy solistët, Marin Gjollma dhe Hysen Hoti do të sjellin për publikun atë që dirigjenti i mirënjohur Eno Koco, e cilëson "ajkën e muzikës orkestrale të përbotshme". Dirigjenti i cili është baketa e këtij koncerti thekson se "tre kompozitorë vihen shpesh së bashku në programet e koncerteve si për të përcaktuar tre epoka apo tri periudha të zhvillimit të muzikës klasike: periudhës klasike që përfaqësohet me Mozart-in, fillimit të romantizmit që përfaqësohet me Beethoven-in dhe kulminacionit të periudhës romantike që përfaqësohet me Brahms-in. Pra janë tre kompozitorët më të mëdhenj të muzikës klasike botërore".

### Maestro Koço çfarë veçantie ka ky program për orkestrën?

Concerti për piano No.1 i Brahms-it luhet për herë të parë në Shqipëri, dhe është një nga veprat më me vlerë të këtij kompozitori edhe pse u shkrua në një moshë të re. Concerti luhet nga Marin Gjollma, një nga pianistët e rinj më me perspektivë e kualitativë të vendit. Marini ka studiuar gjatë në Gjermani, pikërisht në vendin e kompozitorit. Marini synon të përcojë një Brahms sa të peshuar thellë, aq akademik por dhe aq të ndjeshëm. Në pro-



Dirigjenti Eno Koço

vat që kemi bërë me të ai e vendos partin pianistik në një nivel me instrumentet e tjerë të orkestrës, pra që të shkrihet me orkestrën, të jetë pjesë e saj dhe jo të dalë mbi të apo t'i imponohet asaj me lojën e tij. Për Marinin thellësia e tingullit të pianos merr përparësi të veçantë. Sigurisht që Brahms-i ka kërkesa të mëdha dhe ky

interpretim i Marinit mendoj se është fillimi i një rruge të gjatë në versionet e mëpasme interpretuese që ai do t'i bëjë këtij koncerti në të ardhmen.

### Cila është pjesa tjetër instrumentale e këtij koncerti dhe cili është solist i saj?

Concerti për klarinetë e

### Ftesa e Kocos:

"Për ata që duan të mësojnë diçka më tepër nga muzika klasike, ky koncert u jep atyre mundësinë të shijojnë ajkën e muzikës orkestrale të përbotshme. Për ta bërë edhe më të asimilueshme për publikun e interesuar për këtë muzikë, në program janë përfshirë dy instrumentistë, një klarinetist dhe një pianist, si dhe një pjesë orkestrale".

orkestrë i Mozart-it është jo vetëm e vetmja vepër për klarinetë e këtij kompozitori, por dhe një nga koncertet më të njohura dhe më të vështira të repertorit botëror për këtë instrument. Këtë e luan Hysen Hoti, klarinetist i Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar. Vështirësia në lojën e këtij koncerti qëndron në shumë se në çdo gjë tjetër, në detajet e imta të stilit aq të njohur të kompozitorit. Hyseni gjatë provave ka treguar një përgatitje sa intelektuale, aq edhe stilistike, i pasuruar ky vizion i tij me një shije e muzikalitet tepër të vibrant e delikat. Ai ndjen gati deri në qelizë lëvizjen e tempit të secilës prej të tre kohëve të koncertit, ku koha e dytë, aq e famshme

në muzikën savante botërore, nën interpretimin e Hysenit merr një ndjesi sa rrëzëthënë aq dhe hipnotizuese. Mendoj se do të kemi të bëjmë me një zbulim.

### Po lidhur me pjesën orkestrale të programit?

Ajo është uvertura "Leonore No. 3" e Beethoven-it. Kjo uverturë u shkrua për operën "Fidelio", të vetmen opera të shkruar nga kompozitori, dhe u luajt në Vienë më 1806 nën drejtimin e vetë autorit. Uverturat zakonisht përgatisin dëgjuesin për atë që do të ndodhë në skenë pasi të hapet perdia. Por kjo uverturë në fakt përbën një dramë më vete ku shpalosen atmosfera nga më të ndryshmet, që nga ajo gjendje e tensionuar shpirtërore e fillimit të saj, aq dhe magjepsë në tingëllim, për të kaluar në një atmosferë më të çiltër, të vendosur, me shpresën e madhe për atë transformim të madh që do të ngjasë, për të përfunduar drejt një shpërthimi deri në ngazëllim ku pleksen vallja, dinamizmi, drita e shkëlqimi. Kjo lloj muzike mund të konsiderohet si ajo që do të ishte thelbi i dramës muzikore, haresë e heroizmit, tipare këto që lidhen drejtpërdrejt me emrin e Beethoven-it, këtij gjeniu të gjenive.

### JETA ARTISTIKE

11-12-13 MAJ

Galeria Kombëtare e Arteve

"Shqipëria fantastike"

Autor: Ibrahim Kodra  
Kuratori: Rubens Shima  
Ora: 10.00-18.00  
Çmimi: 200 lekë/100 lekë

Piktura të mbledhura nga nga koleksioni i Fondacionit "Ibrahim Kodra" në Milano vepra nga koleksioni i Z. Kozma Dashi vepra nga fondi i GKA, si dhe vepra nga koleksione te ndryshme private.

12-13 MAJ

Teatri Kombëtar i Komedisë

"Fernando Krafi më ka shkruar këtë letër"

Autor: Tankred Dorst  
Regjia: Rogerta Nikolla  
Aktorë: Laura Nezha Ledion Zoi  
Ora: 19.00  
Çmimi: 500 lekë

Fernando një mashkull i pasur dhe i pushtetshëm në shoqëri, i propozon për martesë Julias, një femer e bukur dhe shumë e kulturuar. Qe në fillim ai i imponohet Julias dhe gjate bashkjetesës se tyre.

12-13 MAJ

Teatri i Metropolit

"Endrra ne papafingo"

Regjia: Rexhina Malasi  
Aktorë: Natasha Sela, Kastriot Rramollari, Albana Sançolli  
Ora: 20:00

Tri çifte; një çift me probleme vëmëndjeje ndaj njëri - tjetrit, një çift me problem tradhëtie bashkeshortore dhe një çift "që nuk e njohin më njëri-tjetrin" dhe dy personazhe, rrëfejnë ëndërrat e tyre.

12 MAJ

Teatri i Metropolit

"Pema e Çokollatave"

Regjia: Suela Xhonuzit  
Aktorë: Suela Xhonuzi, Medi Gurra Kaciqi dhe Julian Canameti  
Ora: 10:30

Dy fëmijë Sindi dhe Juli dhe një pemë magjike ... Një pemë e lashtë dhe një mjaft e ditur, e cila di të flas gjuhën e njerëzve. Organizon kuicë dhe lojëra argëtuese dhe fal çokollata.

## Teatër

# "Fernando Krafi..." në Teatrin e Komedisë

Drama "Fernando Krafi me ka shkruar kete leter" shfaqet këtë fundjavë në Teatrin e Komedisë. Vepra boterore vjen nën regjine e regjisorës Rogerta Nikolla dhe interpretimin e aktoreve Ledion Zoi i shpallur si aktori me mire jo protagonist ne festivalin e regjisorëve të rinj, Laura Nezha, tashmë një aktore dhe regjisorë që po afirmohet në skenat tona, dhe Aleksander Kondi. Drama është një nder veprat me të vlerësuar te dramaturgjise bashkekohore, e vene ne shume skena boterore nga kontinenti Amerikan e deri ne ate Aziatik. Fernando një

mashkull i pasur dhe i pushtetshëm ne shoqeri, i propozon per martesë Julias, një femer e bukur dhe shume e kulturuar. Qe ne fillim ai i imponohet Julias dhe gjate bashkjetesës se tyre. "Fernando Krafi me ka shkruar kete leter", një nder veprat me të vlersueshme te dramaturgjise bashkekohore. E vene ne shume skena te botes duke filluar qe nga kontinenti Amerikan e deri ne ate Aziatik. E vlersuar shume dhe nga kritika mbarë boterore. Ne kete veper kemi një histori shume prekesë, ku luajne e mocionet e forta te një marrdhenie bashkeshortore. Fernando një

mashkull i pasur dhe i pushtetshëm ne shoqeri, i propozon per martesë Julias, një femer e bukur dhe shume e kulturuar. Qe ne fillim ai i imponohet Julias dhe gjate bashkjetesës se tyre. I qendron i ftohte dhe indiferent saqe nuk i shpreh dashurine asnjehere te vetme, pavarsisht se Julia insiston gjate gjithë kohes, qe ai te shprehet ne e dashuron. Por ai e injoron kete term dhe sentimentalizmat e saj. Julia e vuan shume indiferencen e bashkeshortit dhe ben gjithë çka te kuptuar ne e dashuron. Pendor kontin Bordavela, i cili e vizitonte shpesh dhe i kishte shprehur asaj

dashurine, e perdor per ta bere xhe-loz Fernandon. Duke i thene se ajo e kishte tradhtuar me kontin. Fernando e fut ne cmendine Julian. Dhe perdor një dhune te forte psikologjike ndaj saj dhe kontit ne sy te doktoreve. Pasi del nga cmendia Julia i kerkon ndjesë per gjithë ka dhe pranon fatin e saj. Ajo dalen-gadalë po vdiste, ne shtratit e vdekjes i kerkon bashkeshortit ti thoshte një here te dua. Tani qe po vdiste Fernando i shpreh dashurine, fillon dhe ben si i cmendur nuk e pranon dot humbjen e saj. Julia vdes ne krahët e tij me pas ai vret dhe veten.

## Dëshiron të qëndrosh në shtëpi?

Luga  
e argjendtë


Receta nga Dhurata Thanasi

# Finoku, tre mënyra gatimi të thjeshta dhe të shpejta

Finoku është fruti i bimës së Ko prës dhe i takon familjes Um belliferae i cili e ka amësinë nga Azia e Vogël, por më vonë është përhapur në gjithë zonën Mesdhetare e njohur dhe përdorur më shumë nga egjiptianët, grekët dhe arabët. Aroma e veçantë që ky frut ka i dedikohet një elementi që quhet anetolo, një esencë që përdoret për përgatitjen e shumë pijeve si Sambuca në Francë, UZO në Greqi, apo Anis në Spanjë. Kjo bimë e mrekullueshme është shumë e varfër në kalori (rreth 31 kalori për 100 gr), yndyrëra porse shumë e pasur në fibra. Është pra një ushqim shumë i mirë për kë do që të ketë një linjë të përsosur. Po ashtu fruti i finokut ka shumë kripëra minerale, mbi të gjitha potas, kalcium dhe fosfor, të vlefshëm për forcimin e kockave dhe parandalimin e lodhjes (për këdo që merret me sport, përdorimi i finokut 2 orë para stërvitjes e ndihmon shumë). Përmban po ashtu shumë vitamina, si vitamina A, e rëndësishme për një lëkurë të mirë dhe për të rregulluar funksionimin e retines së syrit, Vitaminën B që ndihmon funksionimin e mirë të sistemit nervoz dhe aparatit kardiovenoz, si dhe vitaminën C që ndihmon së tepërmi parandalimin e shumë sëmundjeve dhe forcon sistemin imunitar të trupit. Mirësitë dhe ndihma që kjo bimë jep janë të panumërta, sigurisht përdorimi i saj mund të jetë në shumë forma, por si sallatë e freskët, përdorur 2-3 herë në javë ja vien vërtetë! Nëse keni fryrje barku, apo shqetësime pagjumësie, dhimbje të gryke, keqësim të bronkeve, çaji i

### Çaji

Pritni pjesën e sipërme të një kokrrë finoku, aty ku dalin dhe gjethezat sëbashku me degët e koprës. Pritni në copa të vogla dhe vendosini në një enë me ujë. Zijeni për 10 minuta, kullojeni dhe pijeni pa sheqer. Shija është freskuese dhe delikate. Para gjumit ndihmon për këdo që vuan nga pagjumësia dhe gjatë ditës ky lloj çaji shton fuqinë e ul etjen.



finokut është një elisir i vërtetë. Unë e përdor dhe në vend të çajrave të zakonshëm që blejmë në treg. Më poshtë, përveç recetave të radhës do të jap dhe përgatitjen e çajit të finokut.

### FINOKU NË FURRË

**Përbërësit:** 3-4 kokrra finoku  
1 lugë vaj ulliri  
4 lugë gjelle bukë e thekur e grirë  
2 lugë gjelle djath parrmixhan  
Lëng limoni (1 limon)  
Kripë, piper i kuq

**Përgatitja:** Merni kokrrat e finokut dhe pritni në rrrathë dhe vendosini në një tavë të lyer me vaj ulliri. Mbi to hidhni lëngun e limonit, pak kripë, piper të kuq dhe lerini të marinohen për 2 orë. Më pas në një tas bashkonë bukën e thekur të grirë me djathin parrmixhan. Shperndajeni me kujdes mbi gjithë copat e finokut dhe futeni në furrë të nxehtë 180 gradë për 20 min. Servireni në temperaturë ambjenti si shoqëruese filetoshi ose peshku. Është një kombinim i mrekullueshëm dhe me shije delikate të denjë për t'u ngrënë gjatë periudhës së verës.



### Sallata

#### Finok me portokall dhe ullinj



**Përbërësit:** 2 kokrra finokë,  
2 portokalle, Ullinj të zinj pa  
bërthamë Vaj ulliri, Uthull  
balsami, 1 qepë (sipas  
dëshirës)

**Përgatitja:** Të gatuarit e kësaj sallate është proces shumë i thjeshtë. Lani dhe thani me një letër kuzhine kokrrën e finokut, më pas pritni në copa. Qëroni portokallin dhe pritni në feta të holla, mund të shtoni dhe qepët e prera (kjo sipas dëshirës), ullinjtë, kripsoni dhe shtoni uthullën balsamike dhe në fund vajeseni me vaj ulliri ekstra të virgjër. E thjeshtë dhe me shije të mrekullueshme! Servireni të freskët e sidomos në darkë! Ju bëftë mirë!

### Këshilla

## Ato që nuk dini për qershinë

Jeta është si një qershi"- ka shkruar poeti Jacques Prévert, dhe në fakt disa kureshti rreth qershisë e bëjnë këtë frut të pranverës mjaft joshës, ndërsa në francë me ardhjen e pranverës në vend të pusullave, djemtë e kanë bërë zakon të shprehsin ndjenjat e tyre ndaj të dashurave duke u varur në dyert e shtëpive rrënjë qershie. Ndërsa në Japoni ato konsiderohen fruta të shenjta. Britshësia e ulëve të qershisë lidhet me këputjen e jetës, ndërsa ngjyra e kuqe me guximimin e samurajit që sakrifikon veten në emër



të idealeve të larta. Ka gjithashtu dëshmi nga mesjet të cilët tregojnë se qershia është një ilac i mirë kundër hernies. Ju ka ndodhur të keni një ndjesi të keqe në këmbët apo krahe pas një sfrocimi fizik? Kjo mund të largohet

falë lëngut të qershisë, sipas disa studiuesëve amerikanë, mund të risillni veten në formë. Pagjumësia gjithashtu mund të luftohet nga ky lëng. Dy gota me lëng qershie në ditë janë të barabarta me 39 minuta clodhje. Tuli I qershisë shërben për të rivalizuar lëkurën, mjaftojnë 150 gramë dhe një lugë e vogël me vaj ulliri dhe vihet në lëkurë për rreth 10-15 minuta. Qershitë e freskëta shërbejnë për të larguar lodhjen dhe fryrjet sidomos në pjesën e barkut, duke ndihmuar më mirë tretjen e ushqimit.

**NGA PJEKJA NË FURRË** tek një sallatë e shijshme, mjaft e lehtë për tu përgatitur.

### PROGRAMACIONET E FILM TV

SOT



20:00 Emisioni "Fiks Fare"

20:50 Top-Fest 9 Gjysëmfinale



20:10 Skuadra e re pj 42

21:00 Emisioni "Zonë e lirë"



19:55 "Jetë e dyfishtë" pj.89

21:00 Emisioni "Debat"



21:00 Ferri mbi tokë Aksion

21:30 Shqiponja kundër peshkaqenit Komedi

E SHTUNË



20:45 Emisioni "Pop Channel"

20:45 "Big Brother 5" reality show



20:05 "Skuadra e re" pj.46 serial

20:55 "Ezel" pj.74-75 serial



20:00 "Mos e beso po deshe"

21:00 "Histori Dashurie"



19:00 Bija e gjeneralit Triller

21:15 Djemtë që tundin pistën, Dramë

E DIEL



20:17 "Exclusive" dokumentar

21:00 Show Portokalli



20:10 "Anatomia e Greit" pj.106

21:00 X Factor Albania



19:45 "Dancing with the stars" forum

20:45 "Sketch show"



21:00 Udhëtimet e Guliverit Hits

22:00 Xhuzepe De Santis Histori

**Vila 12**

Cdo të premte Lounge Bar, me çmime 200L Lounge Drink,  
Cdo të shtunë Karaoke Night me Kelly, Blerma dhe Graciela  
Cdo ditë një menu e pasur me gatime shtëpie dhe Italiane.  
Cdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shtëpie, dhe një pije.

Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

**RUGA "MUSTAFA MATOHITI",  
PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA**

**Cel. 0696070651**

## Dëshiron të qëndrosh në shtëpi?

**PAS NJË MUNGESË** të gjatë në skenë, drejtori i Teatrit Kombëtar, Kristaq Skrami, vesh petkun e dukës Gloucester tek "Henri VI"

Intervistë e dyzuar mes dukës dhe drejtorit para nisjes për në Londër

ROVENA RROZHANI

vijon nga faqja 13

...Kishit menduar që në fillim se ju do të ishit duka Gloucester apo ishte një zgjedhje e regjisorit?

Kur lexon veprat e Shekspir, ka një galeri pafund personazhesh. Çfarëdo roli që të marrësh në një veprë, të tij ke çfarë të punosh me rolin, është një gjuhë e pastër, një grafikë e ndërtuar e rolit, por gjithmonë për të patur edhe një lloj suksesi rolit, natyrisht që duhet edhe t'i përshtatesh, ose të ta përshtasë regjisorin karakterin me të dhënat e tua aktoriale. Unë mendoj që Gloucester ishte më afër meje, dhe duke më dhënë këtë rol, unë e regjisori konverguam në një pikë. Isha i kënaqur, dhe shpresoj e besoj se kam bërë një rol të mirë.

**Si e ndërtuat karakterin e Gloucester?**

Gjithmonë rolet nga ana profesionale nuk ndërtohen vetëm me atë çfarë shkruan autori në rol. Për të ndërtuar sa më saktë rolin, karakteristikat e rolit duhen gjetur nga batutat apo dialogjet me personazhet e tjerë. Gloucester ka dy tre monologje, njëri prej të cilëve është shumë i gjatë dhe që në fillim të veprës, çka e bën të vështirë. E vështirë sepse vepra nuk ka arritur pikën e vlimit, është menjëherë pas 16-20 batutave të fillimit.

Po ashtu edhe monologu i fundit, por edhe ato cka thonë kundërshtatë e tij, ishin ato që më krijuan të tërën për ta ndërtuar në këtë formë dhe në lloj karakteri. E kam dashuruar që në fillim dhe jo vetëm për potencën që kishte, si një protector i mbretërisë angleze për një 10 vjet. Kjo nuk është pak për të krijuar bërthamën e rolit dhe atë çfarë duhet t'i thosha spektatorit. Ajo që mua më ngroh janë opinionet e mendimet e kolegëve dhe të spektatorëve pas shfaqjes. Kur njëri prej tyre më tha: "E di që të vjen keq që të vrasin ty!" mendova ia paskam arritur deri diku përderisa një spektator arrin t'i vijë keq për personazhin.

**Cilin prej monologëve e keni më për zemër?**

Dy janë, monologu që kam me dukeshën ku ajo vjen për tu rrefyer para se ta dënojnë dhe monologu i fundit kur i drejtohet mbretit dhe i thotë: "Ah hirësia juaj, këto ditë të rreksishme janë! Dhe ka një monolog të gjatë, shumë potent, të bukur, ku i drejtohet të gjithë atyre që e akuzojnë duke u bërë një radiografi shumë të saktë të karaktereve të tyre.

**Ka pasur teatri fërkime mes aktorëve dhe institucionit, ashtu si duka Gloucester... ka pasur momente kur keni bërë krahasime mes punës si drejtor dhe rolit?**

Ka qenë një periudhë tepër e ngarkuar më mua. Është të vras

# Kristaq Skrami, një drejtor nën petkun e Dukës

Nga skrivania zyrtare drejt skenës kombëtare



Kristaq Skrami dhe Yllka Mujo

përgjegjësi e jashtëzakonshme të jesh drejtor i tk, por kjo dhjetefisohet me në një rol të tillë, në një sipërmarrje të tillë, ku duhet të përfaqësosh teatrin shqiptar në një festival ku nuk janë shumë teatro të tjerë europianë.

Padyshim që duke qenë brenda grupit të aktorëve shikojta që kishte mosmarrëveshje, përplasje herë herë artistike, herë herë qejfmbetje, por që besoj se ne i kemi superuar me sukses.

Kam parasysh Jul Qezarin dhe tek monologu i tij ka një sentencë: "Atëherë kur e pa, mbështolli kokën nën tog dhe ra./ Atëherë mosmirënjohja më e rëndë se çdo krah tradhtari e mundi dhe ia theu zemrën. Atëherë Jul Qezari i madh ra/". Vjen para shprehjes së famshme "Edhe ti o Brut". E kam si moton time që mosmirënjohja është gjëja më e keqe që mund të ketë njeriu. Ne themi gjithmonë që tradhtia është gjëja më e rëndë dhe e kemi urreyer si gjënë më të keqe, por sipas Shekspir është mosmirënjohja më e keqe se tradhtia.

**Kur e keni ndier këtë mosmirënjohje?**

Unë jam i detyruar në këtë pozicion që jam, që shumë herë ta superoj. Pavarësisht se jam pak inatçi, kush më njeh nga afër, e di që unë nuk e nxjerr këtë inat. Ata që kanë bashkëpunuar me mua e dinë shumë mirë

që unë nuk jam hakmarrës.

**Kështu i keni ruajtur balancat në Teatrin Kombëtar?**

Është eksperiencë e përbotshme që drejtori i një teatri duhet të jetë artist, qoftë aktor, qoftë regjisor, qoftë skenograf. Por unë mendoj se është më mirë aktori, sepse ai është më afër aktorit, i kupton shumë mirë ambicjet dhe hallet apo problemet që ka. Megjithatë të mbash ekuilibër

në një institucion siç është Teatri Kombëtar natyrisht që është e vështirë. Unë nuk di sesa ia kam arritur, sesa i kam kënaqur të gjithë miqtë dhe kolegët e mi, por ajo që më kënaq është se të paktën ka një frymë bashkëpunimi dhe një klimë shumë të mirë artistike.

**Ka pasur momente kur të shkaktonin dy pozicioneve do të kishit dashur të mos e kishit këtë barrën institucionale dhe të ishit i përqendruar tek duka juaj?**

Padyshim, shumë mirë do të ishte. Por kur je i impenjuar dhe i ten-

### Drejt Londrës

Trupa e Teatrit Kombëtar ka udhëtuar ditën e mërkurë drejt Londrës. Brenda dy ditëve ajo duhet të përshtasë shfaqjen për skenën e Globus Theatre, ku aktorët do të luajnë para 1500 spektatorëve. Skenografia dhe ndricimi i shfaqjes ka mbetur në Tiranë, pasi arena e Globus Theatre nuk e lejon një gjë të tillë. Do të ketë vetëm një fron. Ndërkohë interesi duket i madh. "Nga kontaktet e fundit me ambasadën dhe drejtorin e festivalit ka një interes shumë të madh të bashkatdhetarëve tanë të cilët kanë prerë shumë bileta. Shpresoj që këto dy ditë do të jenë një festë shumë e madhe për ne." - thotë Skrami vetëm pak orë para nisjes për në Londër.

skenës. Por emocionin është edhe kur ti luan përditë e në vazhdimësi. Përgjegjësia ka qenë shumë e madhe ndaj vetes sesi do të prezantohesh para spektatorit, dhe a do të pëlqejë ky rol që kisha realizuar. Në një farë mënyre sigurinë ta jep Shekspiri, gjuha e tij, potencia e fjalës, marrëdhënia që ke me rolin, dialogu shumë i mbështetur, koncij dhe thelbësor.

**Çfarë ju dha dhe çfarë i dhatë Gloucesterit?**

Besoj se i jam dhënë tërësisht Gloucesterit. I kam dhënë ndjenjën, potencën, të folurën e saktë skenik, zërin gjithçka. Ndërsa ai më ka mbushur me siguri për skenën, me dëshirën për të bërë prapë një rol të këtij niveli apo karakteri.

**Do të luani sërish pas këtij roli?**

Pas Gloucesterit do të mendohem mirë se çfarë roli tjetër do të marr. Nuk besoj se do të luaj shumë shpejt, nuk besoj se do marr role me radhë. Do të zgjedh, por në kuptimin për të qenë në nivelet e këtij roli

**I druheni atij që konsiderohet si një konflikt interesi?**

Ndaj unë thashë që do të zgjedh. Në qoftë se do të ishte pjesë me 6-7 personazhe të jeni të sigurt që nuk do të merrja pjesë, por këtu janë 23 aktorë edhe unë e kam të drejtën si aktor që të luaj. Në pjesë me pak aktorë nuk do merrja pjesë sepse do të mendohej se i kam rënë në hak dikujt. Këtu nuk i kam rënë në hak askujt.

**Si ishte marrëdhënia skenike me Yllka Mujon?**


Padyshim që marrëdhënia që ke në skenë me partnerin është vendimtare aq më shumë kur ke përballë një aktore të kalibrit të tillë siç është Yllka Mujo. Marrëdhënia mes dukës dhe dukeshës është tragjike, kur të dy largohen; ajo e dënuar dhe ai pak më vonë nga kjo ndarje bën akuzën e fundit ndaj të kalibrit të tillë... për tu ekzekutuar më pas. Unë e kam ndier veten shumë mirë në raport me Yllkën dhe shumë herë kam pasur ndihmën e saj për rolin. Edhe vendosja që nga bëri koreografia ishte jashtë shablloneve. Pavarësisht se ishim në distancë me njëri-tjetrin, jemi ndier shumë pranë.

**Kanë qëndruar gjithë kohës mirë me njëri-tjetrin duka dhe drejtori?**

Natyrisht që ka pasur momente të tilla, e them me sinqeritet kur mendoja se mbase nuk duhet ta merrja rolin në këtë sipërmarrje kaq të madhe, sepse kishte shumë probleme që duhet të zgjidhja. Por duke e stërforu veten, ia dola. Do isha bërë pishman sikur ta lija. Tani them "Jo, kam bërë gjënë më të madhe që nuk jam tërhequr në skenë"

**Mungesa e gjatë në skenë çfarë ndjesh ju dha në kthim?**

Emocion padyshim, por asnjëherë frikë dhe panik, pavarësisht se u bë një periudhë e gjatë larg



Kristaq Skrami

## Dëshironi të lexoni një libër

**HISTORIA** e familjes Popa  
 frymëzon shkrimtarin Ylljet Alicka.  
 Së shpejti edhe një film

ROVENA RROZHANI

**Q**ë nga «Rrëfenjat me ndërkombëtare» pena e plot humor thumbues e Ylljet Alickës, sikur ishte harruar diku. Por «Valsi i lumturisë» që ka dalë këto ditë në libraritë e Tiranës e thyen këtë harrësë. Ambasadori shqiptar në Francë, i rikthehet sërish lexuesit madje me një histori mjaft, siç është ajo e familjes Popa, vëllezërve dhe motrave që tronditën regjimin komunist me hyrjen e tyre ne ambasaden italiane në Tiranë, në vitin 1985. Alicka thekson se bëhet fjalë për një roman artistik, që përgjithësohet tek përpjekjet e emigrantëve shqiptarë për tu integruar në vendet ku jetojnë, por gjithsesi, gjithçka mbetet për tu zbuluar në faqet e librit, të cilin jua rekomandojmë si leximin e fundjavës. Ndërsa shkrimtarit Alicka

**Më tronditi situata e tyre dhe pamundësia e integritetit të tyre në realitetin e ëndërruar. Gati, gati mu duk si një pjesë e dytë e dramës së famshme "Duke pritur Godonë"**

i kemi kërkuar një informacion më shumë rreth këtij romani të ri i cili me sa duket do të shndërrohet edhe në film.

**Prej një kohe te gjatë nuk lexonim një roman tuajin të ri. Përse keni munguar?**

Pasi më duhet dhe të kryej dhe punën që jam ngarkuar. Nga ana tjetër kur fillon të bëhesh deri diku i njohur, rritet më shumë dëshimi dhe përgjegjësia për veten në lidhje me atë atë që shkruan apo që do të shkruash.

**Si erdhi frymëzimi për këtë roman?**

Nga një shkrim që lexova në gazetën italiane «Corriere della sera» për fatin e familjes shqiptare Popa në Itali. Më tronditi situata e tyre dhe pamundësia e integritetit të tyre në realitetin e ëndërruar. Gati, gati mu duk si një pjesë e dytë e dramës së famshme «Duke pritur Godonë», që në rastin e Popave mund të emërtohej «Godoja erdhi...». Apo për ta thjeshtuar më shumë, te kjo ngjarje më ngacmoi dilema nëse njeriu është më i lumtur në procesin e kërkimit apo pritjes së lumturisë së imagjinuar, apo «kapja e lumturisë» dhe rënia e iluzioneve.

**Cfarë tregon romani "Valsi i lumturisë"?**

Fatin e gjashtë personazheve që kryen një akt të guximshëm, gati gati donkishotesk, në kërkim të lumturisë, apo më mirë një farë

# Alicka: Ju rrëfej "Valsin e lumturisë"

Romani më i ri i Ylljet Alickës në librari



Shkrimtari Ylljet Alicka



Në foto: Kopertina e librit "Valsi i lumturisë"

mirazhi të lumturisë.

**Romani ka një titull që të sjell ndër mend një nga këngët e njohura të këngëtares Vace Zela... Cili është për ju Valsi i lumturisë?**

Ishte më tepër një titull metaforik, që mu duk se i shkonte për shtat stilit të të shkruarit të këtij romani: ëndrra e një martese të lumtur buzë detit blu, nën tingujt e një vals të ëmbël lumturie.

**Lumturia është një mirazh?**

Jo, por mendoj se nuk duhet të jetë diçka që ne i duhet t'i vëmë vetes si objektivi apo qëllim për ta

## Romani

Në këtë roman të ri autori duket se nuk krijon, thjesht tregon një histori, pasi vetë realiteti i ngjarjes ia kalon çdo lloj krijimtari. Alicka tregon për gjëra të tmerrshme në mënyrë të thjeshtë e të natyrshme. Duket që autori i druhet marrjes së një pozicionimi, duke u përpjekur të rrijë jashtë loje.

arritur. Personalisht kam mendimin se nuk është diçka që lidhet domosdoshmërisht me nivelin ekonomik. Më tepër do të thosha lidhet me realizimin e protagonistit profesional e sidomos atij shpirtëror, dmth gjithçka që lidhet me dukurinë e të qenit i dashuruar, në të gjitha dimensionet e saj.

**A e ka lexuar familja Popa**

**kete liber ?**

Nuk e besoj, libri sapo ka dalë. Madje i druhem ndonjë keqkuptimi, pasi ky është një roman artistik dhe jo një dëshmi historike.

**Kujt ia dedikoni romanin ?**

Përpjekjes së tyre për të thyer perceptimin e pathyeshmërisë së izolimit të hekurit të regjimit

**Thuhet se në librin tuaj duket sikur ju nuk krijoni por thjesht tregoni një histori.... Sa histori të vërtetë ka romani juaj?**

Libri u frymëzua tërësisht nga një ngjarje e vërtetë, që tronditi regjimin komunist të kohës, por dhe në përvojat e tjera të shumë shqiptarëve në mërgim. Një pjesë të negociatave diplomatike në roman më është dashur të konsultohem me dokumentacionin mediatik e ar-

## Për shkrimtarin

**K**y është libri i pestë i shkrimtarit Ylljet Alicka, pas tri vëllimeve me tregime: "Parullat me gurë", "Kompromisi", "Koha e puthjeve", dhe romanit "Një rrëfenjë me ndërkombëtarë". Është botuar në disa vende të tjera, si: Poloni, Francë, Itali dhe Rusi. Një pjesë e tregimeve të tij janë shndërruar në skenarë filmi nga vetë autori, me të cilët janë realizuar dy filma artistikë: "Parullat" dhe "Një histori provinciale". Ka marrë disa çmime brenda dhe jashtë vendit: Penda e Argjendit, "Kompromisi", 2001; Romani më i mirë artistik "Një rrëfenjë me ndërkombëtarë", Akademia Kult, 2006; Çmimi i parë, skenari "Parullat", 2006. Është anëtar nderi i "Republikës së Artistëve të Montmartrit", anëtar nderi i Akademisë "Berry-Georges Sand", i shoqatës "La Renaissance française" etj. Aktualisht është ambasador i Shqipërisë në Francë dhe përfaqësues personal i Presidentit të Shqipërisë pranë Organizatës Botërore të Frankofonisë.

shivor.

**Ju jeni ambasador dhe njëherësh shkrimtar... Sa rrinë bashkë këto dy profesione. Ku takohen dhe ku i kundërvihen njëri-tjetrit. Ka raste kur vërtet do të donit të ishit pas skrvivanisë së një shkrimtari sesa të një diplomat?**

Jo, nuk ka ndonjë kontradiktë, ashtu krijimtarinë time si në letërsi ashtu dhe në kinematografi e kam hobi, i cili më ngushëllon kur mendoj se me çfarë do kem të merrem kur të mbaroj funksionet profesionale, që më garantojnë jetesën time dhe të familjes. Njeriu ka ambicie apo oreakt të dallohet e të ketë sukses qoftë dhe në më shumë se një fushë. Por për hir të të vërtetës, pa mohuar dëshirën apo ambicien për "të ecur në letërsi", aktualisht prioriteti im është të jem korrekt me punën që bëj aktualisht.

**Cfarë projektsh të tjera keni si shkrimtar?**


Po merrem me përfundimin e skenarit mbështetur mbi këtë roman, për realizimin e një filmi me metrazh të gjatë, i cili duket se do marrë rrugë shumë shpejt.

**Mund të zbulohet diçka me shumë per filmin?**

Jo shumë, pasi nuk janë firmosur kontratat, por për momentin mund të them se do jetë një film italo-shqiptar - francez dhe se skenari pothuajse ka përfunduar.

## "Parajsa", e Popajt në rrugët e Romës

**N**ë 21 tetor të vitit 2001 gazeta italiane "Corriere della Sera" shkruante për nxjerrjen me forcë të pesë vëllezërve e motrave Popa të moshës nga 60 deri në 80 vjeç, nga shtëpia e pushimit komunal të Romës, ku banonin që nga marrja e statusit si refugjatë politikë në Itali. Ndonëse të moshuar ata janë nxjerrë me forcë duke mos u dhënë asnjë alternativë tjetër banimi apo mbështetje financiare. Familja Popa ishte strehuar aty që prej vitit 1989, kur mbërriti në Itali, pas një ngujimi katërvjeçar brenda godinës së ambasadës italiane në Tiranë, ku kishte hyrë në vitin 1985. Hyrja e tyre duke mashtruar policin shqiptar të ambasadës, ishte akti më i guximshëm që mund të imagjinohej në kohën e diktaturës. Katër vitet që pasuan ishin të mbushuar me tension dhe presion të qeverisë shqiptare ndaj ambasadës italiane për të dorëzuar ata që u cilësuan si "tradhtarë".



[SHQIPTARJA *enditëse*]

## Sulmohet nga leopardët, i shoqi e fotografon

Ndërsa po vizitonte një park natyror në Johannesburg të Afrikës së Jugut, Violet D'Mello një zonjë suedeze u sulmua nga gepardët, të cilët papritmas e sulmuan duke e kafshuar e duke e gjakosur. Fotoja këtu pranë e dëshmon këtë, aq më tepër që poza është bërë pikërisht nga bashkëshorti i gruas së sulmuar nga feli-nët e rrezikshëm, që para se ta ndihmon-te të shoqen kishte shkrepur aparatën për ta fotografuar. Sipas Port Elizabeth Herald, Violet u sulmua nga gepardët ndërsa po mundohej të mbronte dy fëmijë që u ishin afruar shumë. Për fat ndërrhënë menjëherë punonjësit e shërbimit duke shmanjur një tragjedi të mundshme, ndërsa Violet ia hodhi vetëm me disa plagë të parrezikshme për jetën.



## Kur të marton e të dënon i njëjti gjykatës

Jo shumë kohë më parë, çifti amerikan Edward Buckley dhe e fejuara e tij Brenda Wats, pas një periudhe të gjatë që jetonin bashkë, u paraqitën para gjyqarit të gjykatës së Cooperville në Kansas të SHBA, kërkuar që t'i bashkontë më në fund me martesë. Natyrisht që gjyq-tari jo vetëm që pra-noi menjëherë që t'i bshkonte në mar-tesë, por u bëri atyre edhe urimet më të mira. Mirëpo nuk përfundoi me kaq, sepse menjëherë pas kësaj, i njëjti gjyqtar vazhdoi më tej me të dy të sapomartuarit, të cilët në fakt ishin para tij që më parë si të akuzuar për vjedhje, dhe, mbi bazën e pro-vave të pakundërshtueshme që dispononte, i njohu fajtorë për aktin e vjedhjes dhe i dënoi të dy me nga tetë vjet burg...



## Në gjyq supermarketi që ul çmimet

Anglezi Dave Feuerstein, bëri të flitet shumë për të për shkak se ka hedhur në gjyq jo një njeri, por një nga supermarketet më të mëdha të Londrës, pasi, sipas tij, ka qenë pikërisht supermarketi në fjalë shkakta i sëmundjes së tij. Në fakt e vërteta është se gjatë një fushate promovionale të bërë nga supermarketi, ishin ofruar aq shumë artikuj me çmime shumë të lira, saqë kuptohet, si të gjithë të tjerët, Feuerstein, duke mos i rezistuar dot tundimit, bleu çtë mundte dhe... tani ka dëmtuar kurriazin duke i mbajtur. Pikërisht pra për këtë fakt ai ia hesh fajin supermar-ketit si shkakta i fatkeqsisë së tij. "Nuk do të kisha pësuar asgjë nëse supermarketi nuk do të bente oferta të tilla të jashtëzakonshme-thotë ai, prandaj është e drejtë që të paguajnë për dëmin që më kanë shkaktuar...".



### SUPER FJALEKRYQ

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	
21			22					23	24						25	26		27		
28			29				30	31						32	33					
			34				35	36	37	38	39			40						
41	42		43			44							45			46			47	
48			49			50						51	52		53			54		55
			56			57						58	59				60		61	
			62	63								64	65			66	67		68	
			69									70			71			72	73	74
			75									76			77	78		79	80	
81			82				83	84		85					86			87		
88			89				90								91					92

■ **HORIZONTAL**

1. Arti i Horacit.
4. Eshhtë gojë vullkani.
8. Janë plot me hojë
15. Fillojnë periudhën.
17. Një këshilltar për negus.
21. Emri i D'Annunzio-s.
23. Rrethton tokën.
25. Ai i veglave bëhet edhe me diapazon.
28. Inicialet e Mitchum, që qe aktor.
29. Kaçaturian kompozitor.
30. Të parat në stafetë.
32. Emri i lashtë i Irlandës.
34. Janë ndenjëset me rezervë.
35. Janë edhe ato parlamentare.
40. Një turne mjeshtrash nëtenis.
41. Një pjesë e specialistëve.
43. Unë dhe ti.
44. Janë shumë brinjësh në kator.
46. Fiset pa kufij.
47. Kufizojnë pushimin.
48. Eshhtë shtet aziatik.
50. Eshhtë martesë me një... grua.
51. Kështu ishte Narcizi.
54. Kufizojnë një teknik.
55. Kështu përfundon maskarai.
56. Fillojnë nazet.
57. Janë veshjet... intime.
58. Mund të lihen me orar të tilla.
60. U thye nga Narsesi.
62. Janë gjithë e... provincave.
64. Skuadra gigliata në Itali.

68. Ente Ndërtimi Lokale
69. Një fisarmonikë për tango.
70. Organizma Prodhuese Rajonale.
71. Jo kjo... gjë.
73. Një tip... për kërcim.
75. Grazia, nobeliste italiane e letrave.
76. Një incursion me mig.
78. Janë hebrejtë e Gjermanisë.
81. Gibson i kinemasë.
82. Gajshhtë italiane.
83. I famshmi Pacino.
85. Qarkullojnë me... fjalë.
86. Kaluar në krye.
87. Një fjalë goxha.
88. Terence i Don Matteos-.
89. Holm aktor.

■ **VERTIKAL**

1. Eshhtë sulm ushtarak.
2. Memoria në computer.
3. Inicialet e Bean aktor.
4. Shigjetari i... centaur.
5. Eshhtë bota e vërtetë.
6. Emër vajze.
7. Mbyllin aeroportet.
8. Inicialet e Asimov.
9. Qe kaçak.
10. Inicialet e Stone, regjisor.
11. Të parat në sferitë.
12. Detyroheshin të bënin abura.
13. Janë në verë.
14. Krahu pa kufij.
15. Eshhtë fletë... letre.
16. Mund të jetë detar.
17. Emri i Che Guevara-s.
18. Fjordet e Spanjës.
19. Të parat në ambient.
20. Eshhtë tregji me objekte të shenja.
22. Rastet pa set
24. Nuk tuten fare.
26. Gjysma e kështit.
27. Eshhtë lidhja live.
30. Eshhtë regjia në kuinta.
31. Qytet kanadez.
33. Mbyllin një studim.
34. Penn aktor.
36. Shkroi Luli i vocërr.
37. Rregullojnë trafikun.
38. Eshhtë art i të folurit.
39. Fillojnë natën.
42. Të parat në projekte.
44. Shirri këngëtarë.
45. Mbahen në simpoziume.
47. Alo të sportit nuk kanë apartamente.
49. Rafael tenis.
50. Ka një motiv për t'u... kapur.
52. Ishin Dioskurët.
53. Emerson i Emerson, Lake & palmer.
57. Rodrigo,
- mesfushor të Roma.
59. Fillojnë një artin
61. Janë marrdhënie të shumtë të ngushta.
63. Sastre aktore.
65. Shkruhet për janar.
66. Këndon Laura non c'è.
67. Gjysma e arenës.
69. Perfeksionio telefonin.
72. Ai kuq e ka një huq.
74. Sampras tenis.
75. Pax i Zana Turkut.
77. Detar pa zë.
79. Një pjesë e napolitanëve.
80. Zgjetan kur nuk gjen.
81. Mbush vetëm në kufij.
84. Kufizojnë lëvizjet.
85. Ekstreme për zevzek.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHME

P	E	S	H	K	A	T	A	R	I	T	S	H	K	U	R	T	I	P	K	S	A		
A	L	L	E	N	D	E	Q	A	F	B	A	Z	A	R	A	M	A	R	E	T	A	T	
L	I	A	N	E	D	I	L	E	M	E	I	T	P	E	L	E	R	I	N	A	T		
A	R	N	A	S	E	M	A	R	A	T	O	N	I	S	T	V	E	T	E	R	A	N	M
D	E	G	L	E	L	A	B	O	R	A	T	O	R	E	T	N	E	J	O	T	O		
I	D	A	K	O	M	I	S	A	R	I	M	A	I	G	R	E	T	P	E	T	E	R	
N	R	K	R	A	T	E	R	I	E	I	T	R	E	I	M	I	T	U	E	S	I		
I	L	M	I	N	U	T	I	F	G	A	D	E	S	P	N	T	U	T	A				
C	A	R	I	T	A	S	N	A	N	A	K	R	E	O	N	T	I	R	O	G	E	R	
H	A	R	A	M	A	T	A	L	A	R	I	K	U	J	A	N	E	E	Y	R	E	T	
L	I	S	A	E	L	I	M	I	N	A	T	O	R	E	T	E	N	E	I	D	A	N	Y
S	E	P	U	T	H	J	A	S	N	K	O	T	I	S	N	D	E	R					

## HOROSKOPI

**Dashi**  
Tashmë Afërdita është bërë plotësisht dominuese në shenjën tuaj, kështu që sot do të jeni më të prirur për çështjet e zemrës. Kujdes, sepse në planin profesional duket se gjërat kanë ngjitur diku.

**Demi**  
Edhe për ju sot dita do të jetë në përgjithësi e mirë, duke qenë se vazhdon të dominojë një kuadër i favorizues. Marsi 'disi i tërhequr' mund të jetë shkak i hezitimit tuaj në rritje.

**Binjaket**  
Pas një periudhe qetësie relative, duket sot do t'ju rikthehet dëshira për t'ju futur punes ashtu siç dini ju. Do të keni mbështetjen e Merkuri dhe deri diku të Hënës në një orbitë të mirë.

**Gaforja**  
Megjithatë Merkuri sot do të jetë në një orbitë që nuk ju favorizon shumë, në sektorin ku operoni nuk do të keni "kundërshtarë". Por kujdes, sepse keni më shumë rivalë në dashuri.

**Luani**  
Edhe pse keni kaluar një fundjavë në të cilën vërtet jeni kënaqur, duket se keni akoma nevojë për relax, Marsi dhe Saturni mund të bëjnë që sot të mos keni asnjë dëshirë të punoni.

**Virgjëresha**  
Marsi dhe Afërdita do të vazhdojnë edhe sot të jenë në një orbitë të favorshme për ju. Por, që të arrini atë që dëshironi duhet të ndodhëni në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

**Peshorja**  
Largimi i Merkuri nga pozicioni i deritanishëm duket se do të ndikojë negativisht, pasi sot idetë dhe fantazia do të jenë pika juaj më delikate. Megjithatë do të jetë ditë e favorshme për erosin.

**Akrep**  
Një moment i mirë për ju vjen pasi Merkuri kthehet pozitiv në shenjë, prandaj mund do ta keni kuadrin i favorshëm të favorshëm. Në stolgji dhe melankolia sot kanë stimulim e hënës në shenjë.

**Shigjetari**  
"Përplasja" Afërditës me Marsin në shenjë do të jetë e tillë që do të reflektohet në karakterin e shume të lindurve të kësaj shenje në formën më klasike të të qenit i padurueshëm dhe kontradiktore.

**Bricjapi**  
Edhe për ju sot Merkuri do të jetë aleati më i mirë dhe nga kjo do të ketë përfitim afërsia juaj krijuese dhe fantazia. Nuk përjashtohet një njohje e re, që mund të ndryshojë jetën tuaj.

**Ujori**  
Dita e sotme mund të jetë disi e vështirë, sidomos në orët e para, pasi është pikërisht momenti i hyrjes së Marsit "ngatërrestar" në shenjë. Rivendosni dialogun me partnerin.

**Peshqit**  
Kuadri i sotëm duket se do të jetë shumë i favorshëm, sidomos për ata që merren me biznes e kryesisht me tregti, pasi do të jenë në ndikim e Merkuri, që është edhe mbrojtësi i këti sektori.



# Intervista

**RRËFIMI** Olen Cezari, gjeniu i jashtëzakonshëm i violinës dha një koncert në Tiranë në praninë e ambasadorëve të vendeve të ndryshme dhe publikut shqiptar me rastin e Festës së Europës. I vlerësuar në botë si "Paganini i ri" për herë të parë ai rrëfen për Shqiptarja.com gjithçka që nga fëmijëria e tij deri ditën e këtij koncerti.

# OLEN CESARI:

## Si më bojkotoi ambasada shqiptare në Paris

"Artistët, prej vitesh kanë çuar në Europë më të mirën e Shqipërisë, ndërsa sot u takon politikanëve të hapin portat e mbyllura..."

■ ■ ■ **TIRANE**

DHURATA HAMZA



**Në foto:** Olen Cezari në moshën 3-vjeçare duke i rënë violinës

Olen Cezari i është dukur "i këndshëm konteksti i koncertit që u dha në Teatrin e Operas dhe Baletit me rastin e Festës së Europës". "Shqipëria në BE", kjo është kryefjala e këtij gjeniu që për shkak të rrethanave politike gjatë epokës së rënies së diktaturës e s'është pse edhe më pas lihet në dritëhije në vendin e tij, por jo në botë. Shumëkush e di se ai ka nisur t'i bjerë violinës kur shtatin e kishite ende sa ajo, në moshën tre vjeç. Pak nga shqiptarët e kujtojnë djalin e vogël magjik që u ngjiti në skenë më moshën 5-vjeçare si një virtuoz i lindur dhe në moshën 7-vjeçare dha koncertin e tij të parë recital në teatrin "Aleksandër Moisiu" në Durrësit, qytetit ku lindi. Ishite ende foshnje dhe Shqipëria me gjithë hallet e saj, nuk e la pa e vënë re gjeniun e vogël. Në moshën 10-vjeçare e mbaroi gjithë programin e Liceut Artistik dhe si mbaroi këtë ai ishte i vetmi fëmijë mes studentëve 24-vjeçarë që korrite sfidat në Institutin e Lartë të Arteve. Shteti e dërgoi në Romë dhe Italia priti në bankat e shkolis së saj "Paganinin e Ri", virtuozin e jashtëzakonshëm shqiptar. Si u ngjiti ai në skenat botërore dhe çfarë ka ndodhur gjatë këtyre viteve me famën e tij, marrëdhëniet me miqtë dhe jetën në Itali i gjejmë të përshkruara nga vetë ai këtë intervistë.

**Duke ju parë ju në skenë gjatë interpretimit vihet re një ndryshim i madh edhe mes violinistëve më të talentuar... duket sikur muzika rrjedh në gjakun tuaj. Si ka nisur marrëdhënia juaj e parë me muzikën?**

-Isha tre vjeç, kur unë fillova të kem tërheqje nga muzika. Ishite nëna ime që e vuri re këtë. Ajo e kuptoi që unë kisha vesh. Dhe që shumë e zgjuar, mendoj, sepse filloi të me jepte vegla muzikore që gjendeshin në shtëpi në atë kohë. Ato që kishim, se varfëria ishte e paparë në atë periudhë. Nëna më vinte në provë që të luaja me to. Më thoshte bjeri dautles, bjeri violinës, luaj me violinën me hark si me shpata. Kështu ajo filloi të kuptonte se ajo ç'ka merrja në dorë tingëlonte dhe që aty ka nisur përkushimi im ndaj violinës. Kjo gjë më ka çuar mua në rrugën e muzikës, e

cila nuk besoj se do të mbarojë kurrë.

**Ku keni lindur ju, Olen?**  
-Unë kam lindur në Durrës. Jetoj në Romë, por gjithmonë them se kam lindur në Durrës. Në Romë jetoj prej 22 vjetësh dhe tani nëse më thonë "Nga je?", unë them "Jam nga Roma". "Ku ke lindur?", "Kam lindur në Durrës".

**Pra, keni jetuar pjesën më të madhe të jetës në Romë. Përpara se t'ju takoja prisja një gjuhë të ndryshuar, ose së paku ndonjë fjalë të harruar të shqipes. U befasona me pastërtinë dhe saktësinë e shprehjes në shqip...**

**Isha tre vjeç, kur unë fillova të kem tërheqje nga muzika. Nëna ime e vuri re këtë. Më vinte në provë që të luaja. Ajo filloi të kuptonte se ajo gjë që merrja në dorë tingëlonte.**

-Kisha humbur diçka nga gjuha vite më parë, por e kam rifituar sepse kam filluar të frekuentoj më tepër Shqipërinë dhe kjo më ka ndihmuar për ta rifituar gjuhën.

**Tre vjeç ju nisët t'i binit violinës dhe pastaj si u ngjitet në shkollë të suksesit. Çfarë ndodhi më pas me ju?**

-Ndodhi që duke studiuar, duke studiuar e duke studiuar, kur isha dhjetë vjeç kisha përvetësuar të gjithë repertorin e shkollës së mesme artistike, rep-

ertorin violinistik. Dhe si rast i veçantë hyra në konservator. Në atë kohë këtu quhej Instituti i Lartë i Arteve.

**Në moshën 10 vjeç, ju studionit për të lartën?!**

-Po. Gjithë të tjerët ishin 20 deri në 24 vjeç. Nuk i mbaj mend mirë. Ishin shumë të mëdhenj. Edhe unë shkoja në mëngjes gjithë kohën në lice këtu në Tiranë, vazhdoja programin normal të shkollës dhe nga drekë shkoja në Institutin e Lartë të Arteve dhe vazhdoja atje studimet për violinën. E mbarova edhe atë. Katërmëdhjetë vjeç përfundova studimet dhe më evidentuan si instrumentist më i mirë. Pas kësaj u bë një konkurs.

**Për cilat vite bëhet fjalë?**

-Në vitet '88-'89. Unë isha 14 vjeç. Hyra në atë konkurs. Fitova si instrumentist më i mirë i Shqipërisë dhe mu dha e drejta e bursës, sepse në atë kohë nuk jepeshin bursa ose të drejta studimi jashtë shtetit, ishte rast i rrallë. Dhe shkoja në Itali, konkurrova, e fitova. Që në atë moment edhe këtu ndodhi revolucioni: përmbyset regjimi komunist. Revolucionin mua më gjeti në Itali dhe pastaj jeta ime u stabilizua komplet andej.

**A ju kanë pritë në Itali me të njëjtin entuziazëm dhe vlerësim si profesorët tuaj në Shqipëri, apo pati dyshime për talentin tuaj?**

-Për sa i përket entuziazmit për talentin edhe atje nuk më mungoi. Atje u vlerësova direkt, sepse në atë kohë edhe shkolla jonë ishte në një nivel shumë të lartë. Artistikisht

personat që dilnin nga shkollat në Shqipëri dhe që arrinin të merrnin bursë ishin të mirët e Shqipërisë dhe, më të mirët e Shqipërisë, ishin nga më të mirët edhe andej. Nuk ishte ky problemi. Problemi që patën ne andej ishte fakti që revolucioni në Shqipëri erdhi si një stuhi dhe një stuhi e merr çdo gjë përpara. Në atë moment njerëzit e parë që dolën jashtë kufijve ishin edhe personat e parë që bënë gjithë ato zullume të mëdha në Itali. Në vitet e para kështu ndodhi. Ndaj ishte e vështirë të përballoje gjykimin e italianëve nën petkun e paragjykitit para faktit se "je shqiptar". Ka pasur shumë persona që nuk thoshin se ishin shqiptarë për të mos pasur probleme. Kështu që ne mbanim gjithë rrymën që vinte, e mbanim stuhinë në fytyrë gjithë kohën, edhe pse ne ishim personifikimi i shqiptarit në pjesën më të mirë të komunikimit që është kultura dhe arti. Në një farë mënyre ne ishim ambasadorët e kulturës ose ambasadorët e emrit të mirë të shqiptarëve. Më vonë kjo u kapërcye, por nuk ka qenë e këndshme trysnia të paktën për dhjetë vjet, deri atëherë viteve 2000.

**Çfarë pengesash, barrierash ju kanë dalë juve personalisht të paragjykuar si "shqiptari" në ato vite.**

-Unë personalisht nuk kam pasur barrierë në kontaktin e drejtëpërdrejtë, kur vihej në provë talenti artistik, por e kam fjalën si ndiheshja prej mentalitetit që italianët pa të njohur se çfarë dije të bëje paragjykonin dhe në atë epokë e shprehnin këtë. Tani ka ndryshuar komplet muhabeti. Është një qëndrim krejt tjetër që e ka zhdukur paragjykimin. Unë po flas për pas viteve '90. Në atë kohë ekzistonte paragjykim. Sigurisht kur të njihnin dhe dinin se çfarë mund të bëje ndryshonte mendimi. Lëre ata që vinin në koncert, ata thoshin tjetër gjë, por unë flas për qëndrimin e popullsisë normale.

**Keni kaluar gjithë rininë në Itali?**

-Unë jam rritur atje. Kam qenë gysj 14 vjeç.

**Pra, cila ka qenë pjesa më e bukur, e rimisë. Çfarë mbresash keni përjetuar në rininë tuaj të hershme?**

-Rinia ime ka qenë gjithë studime, siç ka thënë Naimi: "Punë,



punë natë e ditë, / që të shohim pakëz dritë." Kështu që unë u diplomova në Romë në moshën 17 vjeç. Mora diplomën atje dhe pastaj në moshën 18-vjeçare shkova bëra dhe një vit tjetër në Austri. Në Itali funksion kështu: ti ke dhjetë vjet për të marrë diplomën, por mund të mbrësh provimet. Kështu që unë mbrojta provimet dhe mora dy vjetet e fundit finale. Kështu që nga moshja 15 deri në 17 e mora diplomën e shkollës italiane, pastaj shkova në konservator e Salsburgut Austri. Ishite katër vjet konservatori si këtu në Tiranë dhe e mbrojta në një vit. Pra në moshën 18-vjeçare kisha mbaruar 3 konservatore: një në Shqipëri, një në Itali, një në Austri dhe thashë po e mbyll tani hesapin me shkollën dhe vijoi karriera konceptore. Koncerte e koncerte gjithandej. Më ka ndihmuar shumë në një emision Pipo Baudo që njihet edhe këtu. Unë fitova konkursin skenik të tij që më hapi shumë dyer dhe gjithë Italia më njohu si fituesi i atij konkursi të vetëm në atë kohë, se tani janë bërë bozë si "Amici", "X factor", etj. Në '92-shin ka ndodhur kjo gjë. U bë bujë në atë kohë. Pipo Baudo më hapi ca dyer dhe kështu unë nisa xhiron e koncerteve nëpër Austri, nisi karriera e muzikës klasike.

**Austrinë e mendonit si vendin e sfidave të reja në muzikën violinistike?**

-Çdo vend në Europë është vend i sfidave, por për muzikën shtetin më interesant e që të vë vërtetë përballë shumë sfidave në muzikë unë quaj Italinë. Sepse Italia ka qenë vatra. Nuk dua të mohoj me këtë se shtete si Gjermania, Austria nuk kanë qenë vatra. Ato janë vatra, ashtu si dhe Franca, tashmë është dhe Rusia, por për mendimin tim Italia ka qenë e mrekullueshme si vend-zgjedhje për sfidat me muzikën.

**Dhe kur filluan gazetat të shkruanin gjithë ato vlerësime që po shkruhen e dëgjojmë sot?**

-Filluan pra në epokën e Pipo Baudos. Nisën të shkruanin gazetat shprehje të tilla si "Paganini i ri".



**JETA IME NË ROMË** Në Itali konkretisht Shqipëria konsiderohet si fqinjë. Ata thonë "Është dera ngjitur me ne". Shumë vite me parë bëhej alarmante çdo e keqe që bënin shqiptarët: "shqiptari" vrau këtë, ky "shqiptari" preu këtë. Tani nuk ka më tendenca për alarme të tilla në media



Në foto: Violinisti Olen Cesari me famë botërore

Çfarë nuk thanë italianët në atë periudhë. Kjo erdh edhe sepse unë bëra një version autentik të Paganinit, Kapriçon 24. U pëlqye shumë. Gjithsesi unë vazhdoja karrierën me muzikën klasike që nga ai moment, por erdh një moment tjetër që unë fillova të lodhesha sepse prezantoja pesë-gjashtë programe: një me koncerte, një me sonata, një si virtuozit. Të gjithë zgjidhnin programin me virtuozizma. M'u bë edhe muzika si punë zyre, por t'i biesh violinës është art. Kështu që unë fillova ta ndjeja veten ngushtë me muzikën klasike dhe fillova të hapja pak horizonte përtej klasikes. Fillova pak me xhazin, bluzin. Kjo nisi me qëndrimin tim në atë periudhë në Nju Jork.

**Sa kohë qëndruar në Nju Jork?**

-Gati një vit filks, por me gjithë koncertet e kam frekuentuar dy vjet.

**Nëse për italianët ishit "Paganin i ri", për publikun e Nju Jorkut kush ishit, sipas referencave të kritikëve ose sipas gazetave?**

-Ishte akoma faza e eksperimenteve. Artikujt dhe vlerësimet erdhën më vonë në Nju Jork. Pasi në atë kohë nuk ishte periudha e vlerësimeve në Nju Jork.

**Kur ishte?**

-Kur bëra koncertin me Lucio Dalla-n, me atë artistin "e qmendur". Aty nisën artikujt e parë "Artisti nga Shqipëria që luan me Lucio Dalla-n".

**Duke ju njohur nga afër, dukeni "me këmbë në tokë", i thjeshtë, natyral në sjellje. Si ka mundësi që transformoheni aq shumë në skenë, dukeni shumë virtuoz, shumë rebel, krejt ndryshe**

**nga njeriu që kam përpara?**

-Ndodh natyrshëm, sepse unë jam rritur në skenë. Kur kam qenë i vogël, koncertin e parë e kam bërë në Durrës, kur isha 5 vjeç. Recitalin e parë e bëra në Teatrin "Aleksandër Moisiu", isha 7 vjeç. Isha foshnje. Kur ngjitem në skenë më duket akti më normal më intim. Jam më vetvetja kur jam më skenë, sepse pjesa tjetër jashtë saj është plot probleme, trazira, shqetësime, turbullira. Madje tashmë para koncerteve shqetësohesh edhe a hyjnë miqtë e tu në koncert apo jo, a gjeten vend të mirë apo jo. Këto janë halle të mëdha se u ngelet hatri miqve (qesh). Kur vjen momenti që ti pret skenën, mbyll telefonin, përqendrohesh dhe më në fund jam rehat, bëj atë që duhet të bëj, jam në momentin që lidhet shpirti im me një instrument që është violina dhe me atë unë transmetoj atë që dua të them.

**Pra rruga juaj paska qenë e gjatë dhe megjithatë me këto zbritjet dhe ngjitet nga toka në "qiellin e muzikës", besoj se kanë sjellë gjëra të bukura, sfida, emocione....**

-Emocione...? Dje, për shembull, kur erdha këtu në Tiranë për festën e Europës, erdha i gëzuar se konteksti ishte shumë i këndshëm. Koncerti u bë në teatrin e Operës dhe Baletit në Tiranë. Na kishte ftuar Ettore Sequi dhe Arditi prezantonte. Ishin të gjithë ambasadorët. Erdhi një moment që më preku, sepse po flitej që Shqipëria akoma nuk ka marrë statusin e kandidatit për të hyrë në BE. Kjo domethënë që ti nuk je ende anëtare e kësaj vëllazërie, e një familjeje. Të jesh anëtar i kësaj familjeje duhet të kesh në rregull ca kritere. Ne që s'jemi aty, akoma nuk kemi të drejtë të bëjmë as kërkesën. Këtu ka diçka që nuk shkon, edhe pse unë nuk merrem me politikë. Nuk e di se çfarë nuk shkon, por ideja është që secili nga ne të kërkojë e të jap një dorë.

**Ju artistët e keni dhënë një dorë. Ne kemi korifeng të skenave evropiane: jeni Ju, është Tedi Pavaramin, Inva Mula, Saimir Pirgu, etj. etj.**

-Po. Ne artistët e kemi dhënë dorën. Prej vitësh na quajnë ambasadorët e kulturës shqiptare. Ne marrim më të mirat e Shqipërisë dhe i çojmë nëpër botë. Por personat që merren me këtë punë, politikanët le të gjejnë një rrugë, të bëjnë një marrëveshje që të paktën të dimë ç'të themi edhe ne. Unë po shoh ndryshime këtu. Kur kam ardhur në 2000-n unë kisha frikë të vija. I thashë Arditi "Të lutem, eja më merr në aeroport". Isha akoma me përshtypjen e aeroportit si një kolibe me ushtarë aty tek dera e tij, me automatikë që të prisnin. Tani i sheh shumë ndryshe gjërat në Shqipëri.

Mendon se kjo pengesë e

**hyrjes në BE ka të bëjë me drejtësinë, ligjet, korrupsionin e politikanëve?**

-Unë këto gjëra nuk kam si ti di. Por mendoj se janë politikanët ata që ka më shumë në dorë të bëj diçka dhe sa më shpejt. Edhe Europa po kalon një fazë jo të këndshme, për sa i përket perspektivave ekonomike.

**Ju gjatë bisedës thatë që mentaliteti i italianëve për shqiptarët ka ndryshuar. Konkretisht si mendojnë në këtë periudhë?**

-Në Itali konkretisht Shqipëria konsiderohet si fqinjë. Ata thonë "Është dera ngjitur me ne". Shumë vite me parë bëhej alarmante çdo e keqe që bënin shqiptarët: "shqiptari" vrau këtë, ky "shqiptari" preu këtë. Tani nuk ka më tendenca për alarme të tilla në media.

**Pra ka një dëshirë të italianëve që ne të jemi në BE?**

-Unë di që italianët e dinë përkryer historinë tonë më të mirë, e dinë që ne kemi pasur një Skënderbe, e dinë çfarë ndodhi me vendin tonë. E dinë se jemi ndryshe nga sa jemi përgojuar dhe tani unë dëgjoj plot miq italianë që thonë hajde të bëjmë "vakancën" në Shqipëri, jo vetëm se është më pak e kushtueshme por edhe se e dinë që ka stabilitet. Por nuk duhet ta presim ndihmën vetëm nga bota, duhet të ndihmojmë më shumë vetveten.

**Në ç'menyrë?**

-Mua më ka mbetur peng për shembull, kur isha në një koncert në Paris, regjisori që fitoi pesë çmime oskar Michel Hazanavicius, bëri një artikull për mua në "L'Express". Artikulli bëri bujë në Francë. Koncerti u bë që të më njihnin njerëzit konkretisht në skenë pas artikullit. Dhe, unë shkova në Paris, folë nëpër radio, e shumë media. Koncertin e organizoi një djalë nga Shqipëria që quhet Rrezart Jasa, një organizator shumë i mirë. Ndodhi diçka shumë e çuditshme. Kisha të ftuar në koncert ambasadorin dhe stafin e Ambasadës Shqiptare në Paris dhe nuk munda të ftoja asnjë nga Ambasada Italiane, (edhe pse unë e kam në pasaportë edhe kombësinë shqiptare, italianët mburreshin me mua). Çfarë ndodhi në këtë moment?! Unë pashë 20 persona nga Ambasada Italiane, përfshi ambasadorin dhe gjithë të tjerët dhe nuk pashë asnjë person nga Ambasada Shqiptare. Personalisht më preku kjo gjë. Më bëri të mendoj se ambasadat tona, që duhet të jenë receptorët përmes të cilëve ne të përfitojmë për anëtarësimin në BE dhe që të na hapen dyert në Europë, nuk e kryejnë këtë funksion. Çdo njeri që është nëpër botë përfaqëson, jo vetëm veten e vet, por edhe kombin. Flas për kombin për atë që quhet mëmëdhënë, vendi ku ke lindur. Bota sot është vërtetë në lëvizje, por askush as në Nju Jork, as në Romë, as në Francë nuk e mohon vendin ku ka lindur.

# DONIKA MUSTAJAJ

## Dokumentari, rrëfëj ndrydhjen e fëmijëve në shkolla



Donika Mustafaj

Donika Mustafaj në dokumentarin e saj të gjashtë "Shkolla...pse duhet" është kushtuar një çështjeje sublimë. Me regji dhe skenar të Donika Mustafaj, me producent Ferdinand Selën, me kamera të Agim Kurit e Denis Grepcas, montazh të Elton Capanit, miksoz të Ermal Bardhit, operator të zërit Kristaq Kristo, dokumentari u shfaq premierë dje në orën 19:30, në kinema "Millenium". "Shkolla, "si mbretëri" e mësuesve apo fëmijëve", ngre zërin Mustafaj. "Shkolla...pse duhet" është një dokumentar që i rikthehet sërisht një teme të mprehtë shoqërore, ku në qendër të problematikës janë fëmijët. Në qendër të vëmendjes Donika Mustafaj sjell shkollën e vëzhguar në trekëndëshin e marrëdhënieve fëmija-mësuesi-prindi. "Në vendet e familjes perëndimore, shkolla i paraprin shoqërisë", tha ajo pas shfaqjes së këtij dokumentari, "ndërsa në Shqipërinë e sotme shoqëria është më e përparuar se shkolla". Duke i mësuar prapambetjes së shkollës në Shqipëri, Donika Mustafaj i bën një skanerizim të plotë gjendjes së shkollës, me pikësynimin për të nxjerrë në pah problemet dhe të rrisë ndjeshmërinë e shoqërisë ndaj këtyre problemeve. Fëmijët, të gjendur në një fare rrethi vicioz, i përshatën situatës. Pajoja me e rende mbi ta është një ngulitje e vetëdijes se pajtimit me të keqen. Ata, megjithëse janë të kthjellët për t'i identifikuar problemet, siç edhe del nga intervistat me ta, nuk ngrenë zërin, të bindur se ose rrezikojnë të ndëshkohen, ose është e kote pasi nuk dëgjojnë. Kjo vetëdije e pajtimit me të keqen të qytetarit e ardhshëm të Republikës së Shqipërisë është demit më i madh

**"Shkolla...pse duhet": në qendër të vëmendjes Donika Mustafaj sjell shkollën e vëzhguar në trekëndëshin e marrëdhënieve fëmija-mësuesi-prindi**

që i bëhet të nesërmas, thotë regjisorja. "Tek fëmijët nuk kultivohet të menduarit kritik dhe krijues. Vihet re se sot me shume se kurrë ne historinë e arsimit shqiptar, shkolla konsiderohet kryesisht "si mbretëri" e mësuesve.", tha ajo duke shtuar se këtu ka mangësi edhe roli i prindërve "Vihet re se prindërit, ne emër të një pragmatizmi jo të shëndetshëm e që reduktohet të nota e mire për fëmijën, pranojnë një rol periferik dhe konformist. Komunikimi prind-mësues-nxënës është pa një thelb të vërtetë, formal dhe me shume i rastësishëm se sa i strukturuar. Prindërit pranojnë ta shohin frekuentimin e shkollës nga fëmija i tyre vetëm si mundësi për t'u pajisur me një liste notash të mira, të cilat do ta çojnë të riun ne universitetin.", tha Mustafaj pas shfaqjes.

**LAJME  
NGA BOTA**

**Hollande pas betimit  
takon Merkel**

Presidenti i ri francez, Francois Hollande pritet të takohet të martën, më 15 maj me kancelaren gjermane, Angela Merkel. Hollande do të udhëtojë për në Berlin pasditën e së martës, pas betimit në "Ellysee", ku do të zëvendësojë presidentin në ikje, Nicolas Sarkozy. Ashtu sic është paralajmëruar nga mediat dhe nga vetë Hollande përgjatë gjithë fushatës së tij elektorale, kancelares gjermane do t'i propozohet rishikimi i paktit fiskal dhe gjetja e rrugëve të tjera alternative, sipas Hollande, më pak të dhimbshme për qytetarët e Bashkimit Europian për të rivendosur në rrjetje ekonominë.

**Presidentja lituaneze  
viziton Timoshenkon**

Zyra e presidentes lituaneze Dalia Grybauskaitė tha se ajo do të përpiqet që ta vizitojë ish-kryeministren ukrainase Julia Timoshenko, e cila aktualisht gjendet në një spital në qytetin ukrainas të Karkivit. Vizita sipas saj do të ndodhë të premten. Timoshenko, e cila po vuan dënimin shtatëvjeçar për shpërdorim të detyrës zyrtare, u zhvendos të mërkurën nga burgu në spital, për trajtimin e dhimbjeve të shpinës. Nëse Grybauskaitė lejohet ta vizitojë Timoshenkon, do të bëhet udhëheqëseja e parë e huaj që e viziton atë, që kur u dërgua në burg në tetor të 2011-es.

**Mjekët vërejtje Obamas:  
Mjaft me hamburgerë**

Mjaft më me hamburger, hot-dog, patate të skuqura... të pakitën para publikut. Kritika në fjalë vjen nga një shoqatë mjekësh në Uashington ndaj Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Barack Obama. Sipas tyre Obama e shfaq shpesh pasionin e tij për ushqimet e fast-food pasi vazhdimisht kapet duke konsumuar dhe kjo stimulon keqshqyerjen dhe obezitetin. Pasioni i tij për këto ushqime bie ndesh me fushatën e zornjës së parë Michelle Obama e cila promovon ushqimet bie dhe të shëndetshme, kundër mbipeshës dhe një ushqimi të shëndetshëm.

**Shok në Angli, 630  
minorene të dhunuara**

Shok në Britaninë e Madhe. Mbi 630 vajza minorene, kryesisht të cenushme, janë dhunuar sistematikisht në 5 vitet e fundit nga një bandë pedofilësh që rrëmbente nga shtepi strehimi për të miturit. Ngjarja tronditëse është zbardhur në Liverpool, si pasojë e dënimit të 9 meshkujve me origjinë aziatike, por gazeta "Times" shkruan se ngjarja ka përmasa më të mëdha sesa ato të zbuluara gjatë procesit. Banda, që përfundoi në burg pasi kishte organizuar trafikimin e minoreneve, përbëhej nga tetë pakistanezë me shtetësi britanike dhe një afgan që ishte në pritje të azilit. Ata punonin si taksistë ose fatorin dhe janë të moshave nga 22 deri në 59 vjeç. Ata janë dënuar për dhunim, trafik minorene dhe pedofili, për një total prej 77 vitesh burg. Viktimat e tyre, 187 prej të cilave janë dhunuar në 11 muajt e fundit, janë të gjitha vajza të bardha dhe shënjestroreshin nga banda pasi nuk kishin mundësi të mbroheshin.

**Venizelos merr mandatin  
për krijimin e qeverisë greke**  
Kryetari i PASOK-ut, Evangelos Venizelos ka marrë dje mandatin për krijimin e qeverisë së re greke. Pas dështimit të liderit të Koalicionit të së majtës (SYRIZA), Aleksis Tsipras, Venizelos është paraqitur tek presidenti i Republikës, Karolos Papulias, për të marrë mandatin. Pas takimit me Tsipras, Venizelos theksoi se vendi nuk ka kohë për të humbur dhe se vazhdimi i pasigurisë është në dëm të Greqisë. Nëse dhe Venizelos, nuk ja arin qëllimit, Greqia do të shkojë me siguri në zgjedhje të reja pas tre ose katër javësh.

**Në Afganistan 11 të vranë**

Sulmues vetëvrasës, me uniforma policie, kanë vrarë pesë persona në juglindje të Afganistanit. Burimet zyrtare thonë se sulmuesit janë kapur teksa kanë bërë përpjekje të kalojnë vjedhurazi në një postbllok të policisë në provincën Paktika. Shefi i policisë, Davlat Khan Zadran, tha se të gjashtë sulmuesit kanë vdekur në operacionin e dështuar të tyre. Ai tha se personat e armatosur kanë dashur të qëllonin një zyrë të qeverisë së qarkut, por janë ndaluar në postbllok. Gjatë luftimeve, katër sulmues kanë vdekur pasi kanë shpërturyer eksplozivët, ndërsa dy të tjerë janë qëlluar. Dy civilë dhe tre zyrtarë policie kanë humbur jetën po ashtu në luftime.

Bashkia Himare ju fton

**Open 2012  
Summer  
Season  
12-13 Maj**



**NJË FUNDJAVË  
E MAGJISHME!!!**

**E SHTUNË**

NRG Band / Flor Mumajesi / Elvana Gjata \ Klajdi Haruni \ Andy Gramm dhe shumë të tjerë!

**E DIELË**

Vëllezërit Korçarë / Animator / Parashuta / Alpinizëm / Zhytje / Ushqim tradicional.

**Dhe më e rëndësishmja AKOMODIMI FALAS PËR TË GJITHË**

Për më tepër informacion vizitoni  
[www.himara.gov.al](http://www.himara.gov.al)

SPONSORIZUAR NGA:



MBESHETUR NGA:



Alba Malltezi  
Drejtoresh e Përgjithshme  
e Free and Fair Media Group

Anila Basha  
Drejtoresh e Shqiptarja.com  
Arben Rrozhani  
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena  
Ekonomia: Genc Kondi  
Kronika: Elton Qyno

Sociale: Esmeralda Keta  
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj  
Genti Manelli  
Website: Suela Gera  
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:  
Cel: +355696060419  
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:  
Saimir Zenelaj  
Cel: +355696060418